



# REFORMA NË NGËRÇ

Raporti i monitorimit të zbatimit të  
**Strategjisë për Sundimin e Ligjit**  
dhe Planit të Veprimit 2025–2026



Një analizë e sundimit të ligjit në Kosovë bazuar në gjetjet mbi mekanizmat e monitorimit dhe zbatimit institucional.



Institucione përgjegjëse.  
Zbatimi i aktiviteteve.  
Rezultate në praktikë.



Vlerësim.  
Analizë.  
Rekomandime.  
Për një sundim të ligjit më efektiv.



PRISHTINË  
2026



**Autorët:** Qemajl Marmullakaj, Naim Jakaj dhe Melos Kolshi

**Ekipi redaktues:** Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi – IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).*

Implementur nga:



Mbështetur nga



## **RRETH IKD**

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

Adresa: Rr. Ilaz Agushi, Prishtinë

[info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Maj, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit ..	6
3. Rishikimi funksional dhe Strategjia për Sundimin e Ligjit .....	7
4. Pritjet nga Rishikimi Funksional i Sundimit të Ligjit dhe Strategjia për Sundimin e Ligjit ...	7
5. Mos miratimi i Planit të Veprimit brenda afatit duke lënë një vit strategjinë të pazbatueshme .....	11
6. Rishikimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit.....	12
7. Plani i Veprimit 2025-2026.....	14
8. Buxhetimi i Strategjisë.....	17
9. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit .....	19
10. Përbushja e veprimeve sipas objektivave strategjike dhe sipas institucioneve përgjegjëse	20
11. Përputhshmëria e Programit Legjislativ me planin e veprimit .....	37
12. Çfarë synohej vs. çfarë u arrit me Strategjinë e Sundimit të Ligjit .....	39
13. Mungesa e monitorimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit .....	41
14. Si duhet t'i qaset Qeveria Sundimit të Ligjit, pas përfundimit të strategjisë .....	42
15. Rekomandime .....	44

## Lista e shkurtesave

<b>RFSSL</b>	Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit
<b>SSL</b>	Strategjia për Sundimin e Ligjit
<b>PV SSL</b>	Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Sundimit të Ligjit
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>ONDK</b>	Oda e Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës
<b>OPPK</b>	Oda e Përmbaruesve Privat të Kosovës
<b>IKD</b>	Instituti i Kosovës për Drejtësi
<b>ANJF</b>	Agjencia për Ndhmë Juridike Falas
<b>Komisioni për Legjislacion</b>	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit
<b>ShKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>ShSK</b>	Shërbimi Sprovues i Kosovës
<b>AD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>APK</b>	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
<b>OAK</b>	Oda e Avokatëve të Kosovës
<b>AIP</b>	Agjencia për Informim dhe Privatësi
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>KPPRK</b>	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021–2026 përfaqëson dokumentin kryesor strategjik për reformën në sektorin e drejtësisë në Kosovë, me synim forcimin e gjyqësorit, rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi. Megjithatë, gjetjet e këtij raporti tregojnë se zbatimi i Strategjisë gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga progres i kufizuar, nivel i lartë i aktiviteteve të pazbatuara dhe mungesë e rezultateve të qëndrueshme në praktikë.

Një nga problemet më serioze që ka ndikuar në zbatimin e Strategjisë ka qenë mungesa e Planit të Veprimit gjatë vitit 2024 dhe miratimi me vonesë i Planit të Veprimit 2025–2026 vetëm në shkurt të vitit 2025. Për pasojë, Strategjia ka funksionuar për një periudhë të konsiderueshme pa një kornizë operative të qartë për zbatim, monitorim dhe raportim.

Për më tepër, Plani i rishikuar i Veprimit ka ruajtur mangësi të konsiderueshme, veçanërisht në aspektin e planifikimit financiar, prioritizimit të aktiviteteve dhe lidhjes së reformave me rezultate konkrete dhe të matshme. Mungesa e kostimit të shumicës së veprimeve dhe mungesa e vlerësimit të ndikimit buxhetor ngre shqetësim mbi përputhshmërinë e këtij dokumenti me rregullativën në fuqi.

Në të njëjtën kohë, viti 2025 është karakterizuar nga një krizë e theksuar institucionale dhe politike, e ndërlidhur me zgjedhjet parlamentare, funksionimin me Qeveri në detyrë dhe moskonstituimin e Kuvendit për një periudhë të gjatë kohore. Këto rrethana kanë ndikuar drejtpërdrejt në miratimin e projektligjeve, funksionalizimin e mekanizmave të Strategjisë dhe koordinimin ndërinstitutional për zbatimin e reformave të parapara. Si rezultat, një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve kanë mbetur në fazë të hartimit, konsultimeve publike ose procedurave fillestare institucionale.

Monitorimi i objektivave strategjike dhe specifike tregon se progresi ka qenë i pabarabartë ndërmjet sektorëve të ndryshëm të drejtësisë. Në sistemin gjyqësor dhe prokurorial janë evidentuar vonesa në reformën ligjore, transparencën dhe efikasitetin procedural, ndërsa në drejtësinë penale progresi ka qenë më i kufizuar në fushat që ndërlidhen me drejtësinë për të mitur, konfiskimin e pasurisë dhe mekanizmat e koordinimit institucional. Në fushën e qasjes në drejtësi, bashkëpunimit me publikun dhe shoqërinë civile, shumica e aktiviteteve kanë mbetur të pazbatuara ose janë realizuar vetëm pjesërisht.

Megjithatë, raporti evidenton edhe disa zhvillime pozitive, përfshirë themelimin e Gjykatës Administrative, avancimin e disa sistemeve elektronike, organizimin e trajnimeve profesionale dhe procedimin e disa projektligjeve prioritare. Po ashtu, disa institucione kanë shënuar progres më të dukshëm në digjitalizim, ngritje të kapaciteteve profesionale dhe bashkëpunim institucional.

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se Strategjia për Sundimin e Ligjit nuk ka arritur nivelin e reformës së paraparë, ndërsa zbatimi gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga mungesë e progresit të qëndrueshëm, aktivitete të pazbatuara, planifikim i dobët financiar dhe koordinim i mangët

institucional, duke evidentuar nevojën për mekanizma më funksionalë të planifikimit, monitorimit dhe zbatimit të reformave në praktikë.

## **2. Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit**

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit është bazuar në një analizë sistematike të dokumenteve strategjike dhe burimeve publike relevante. Fillimisht, është shqyrtuar Rishikimi Afatmesëm i Strategjisë, si dhe Plani i Veprimit, nga i cili janë identifikuar dhe ndarë të gjitha aktivitetet e parapara për vitin 2025 për secilin institucion përgjegjës dhe mbështetës.

Vlerësimi i progresit në zbatim është mbështetur kryesisht në të dhëna publike. Burimet e informacionit kanë përfshirë faqet zyrtare të institucioneve, Gazetën Zyrtare, vendimet e Qeverisë raportet vjetore institucionale, raportet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), raportet e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), si dhe publikimet dhe njoftimet në rrjetet sociale dhe mediat vizuale dhe elektronike në vend. Përveç të dhënave publike IKD ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë dhe Odën e Përmbauesve Privatë, si dhe përmes komenteve dhe kontributeve të pranuar nga Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Oda e Ndërmjetësuesve dhe Zyra e Kryeministrit.

Për secilin aktivitet të identifikuar, është bërë një vlerësim i statusit të zbatimit duke u bazuar në evidencat e disponueshme. Aktivitetet janë klasifikuar, ashtu siç edhe janë paraqitë në plan të veprimit, në tri kategori: të zbatuara, pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara. Në rastet kur nuk ka pasur të dhëna publike, apo nuk kemi informuar nga institucionet për veprimet institucionale që dëshmojnë zbatimin e një aktiviteti, ai është konsideruar si i pazbatuar, duke reflektuar qasjen e bazuar në transparencë dhe evidencë.

Kjo qasje metodologjike synon të ofrojë një pasqyrë objektive dhe të verifikueshme të nivelit të zbatimit të Strategjisë, duke u mbështetur në burime të hapura, në të dhëna të ofruara nga institucionet përkatëse dhe në analiza të krahasuara ndërmjet aktiviteteve të planifikuara dhe zhvillimeve reale në praktikë.

### **3. Rishikimi FunkSIONAL dhe Strategjia për Sundimin e Ligjit**

Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL) paraqet një proces gjithëpërfshirës analitik dhe vlerësues të inicuar nga Qeveria e Kosovës, i miratuar në vitin 2016, me qëllim adresimin e mangësive strukturore dhe funksionale në sektorin e sundimit të ligjit. Zbatimi i tij ka filluar në vitin 2018 dhe është zhvilluar në disa faza të ndërlidhura analitike dhe konsultative me institucionet e drejtësisë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Faza e parë e procesit është fokusuar në identifikimin e të metave dhe sfidave kryesore në institucionet e sektorit të sundimit të rendit dhe ligjit. Mbi këtë bazë, faza e dytë ka avancuar në një analizë të thelluar sektoriale, e cila është materializuar përmes hartimit të 16 dokumenteve të politikave. Këto dokumente përmbajnë rekomandimet kyçe dhe janë strukturuar në katër shtylla kryesore: (1) sistemi gjyqësor dhe prokurorial; (2) drejtësia penale; (3) qasja në drejtësi dhe shërbimet jo-gjyqësore; dhe (4) lufta kundër korrupsionit, duke përbërë bazën analitike për ndërhyrjet reformuese në sektor.

Procesi ka kulmuar në vitin 2020 me miratimin e këtyre rekomandimeve nga Komiteti Drejtues, duke hapur rrugën për fazën e hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit. Si rezultat, në vitin 2021 është miratuar Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021–2026<sup>1</sup>, e cila përfaqëson dokumentin e vetëm strategjik në këtë fushë. Strategjia përcakton vizionin, objektivat dhe mekanizmat e zbatimit, monitorimit dhe raportimit, të strukturuar rreth katër objektivave themelore: forcimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial, fuqizimi i drejtësisë penale, përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe intensifikimi i luftës kundër korrupsionit.

Në këtë kuptim, Strategjia për Sundimin e Ligjit përfaqëson produktin e një procesi të detajuar analitik dhe konsultativ të RFSSL-së, duke operacionalizuar drejtpërdrejt gjetjet dhe rekomandimet e këtij procesi në masa dhe veprime konkrete reformuese. Strategjia e Sundimit të Ligjit shërben si korniza kryesore udhëzuese për transformimin e sektorit të sundimit të ligjit, me synim rritjen e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies dhe besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë.

### **4. Pritjet nga Rishikimi FunkSIONAL i Sundimit të Ligjit dhe Strategjia për Sundimin e Ligjit**

Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL) është konceptuar si ndërhyrja më gjithëpërfshirëse dhe më ambicioze reformuese në sektorin e drejtësisë në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë. I inicuar në vitin 2018 dhe i zhvilluar në disa faza deri në vitin 2021, ky proces synonte të adresojë në mënyrë sistematike problemet strukturore të sektorit, përmes një analize të thelluar dhe një pakete të qartë rekomandimesh të përkthyer në politika konkrete. Rezultati final i këtij

---

<sup>1</sup> Vendimi nr 04/2024 i Qeverisë së Kosovës, Prishtinë 2021. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=45816> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

procesit, Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021–2026, u prezantua si një “moment historik” për reformën në drejtësi dhe si një pikë kthese drejt ndërtimit të një sistemi më efikas, të pavarur dhe të besueshëm.

Pritjet nga RFSSL dhe SSL ishin jashtëzakonisht të larta, si nga institucionet vendore ashtu edhe nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile, duke reflektuar rëndësinë që ka strategjia si dokument kyç për avancimin e reformave në drejtësi në Kosovë. Institucionet e Kosovës e kanë paraqitur strategjinë si një kornizë gjithëpërfshirëse për adresimin e sfidave kryesore në sistemin e drejtësisë, përfshirë rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe prokurorive, forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstytucional<sup>2</sup>. Në këtë kuptim, pritjet institucionale kanë qenë që strategjia të prodhojë rezultate konkrete dhe të matshme, të cilat do të kontribuonin në rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Në anën tjetër partnerët ndërkombëtar kanë paraqitur qëndrimet dhe pritjet e tyre ndaj këtij procesit. Ambasada e Shteteve të Bashkuara e cilësoi procesin e RFSSL dhe strategjinë e dale nga ky proces si një “ndërmarrje masive” dhe një moment kyç për forcimin e sundimit të ligjit, duke theksuar se sukcesi i tij varet nga përqaftimi i plotë i rekomandimeve nga institucionet vendore dhe nga implementimi i tyre në praktikë<sup>3</sup>. Ngjashëm EULEX Kosova e kanë mirëpritur miratimin e strategjisë si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të sundimit të ligjit dhe përafrimit me standardet evropiane. Megjithatë, pritjet e tyre kanë qenë të kushtëzuara qartë nga zbatimi efektiv i saj, duke theksuar nevojën për rezultate të prekshme në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, rritjen e integritetit institucional dhe garantimin e pavarësisë së sistemit të drejtësisë<sup>4</sup>. Në këtë drejtim, strategjia është parë jo vetëm si një dokument politikash, por si një test i përkushtimit të Kosovës ndaj reformave reale në sektorin e drejtësisë. Ky pozicion i Ambasadës së SHBA-ve dhe EULEX-it në Kosovë reflekton një pritje të qartë, prandaj RFSSL dhe strategjia e sundimit të ligjit nuk duhej të ishin vetëm një ushtrim analitik, por një proces transformues me ndikim real në sistemin e drejtësisë.

Në të njëjtën linjë, Bashkimi Evropian, përmes raporteve për vendin të Komisionit Evropian, që nga inicimi i procesit të Rishikimit Funkcional e deri në vitin e fundit të zbatimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit (2019–2025), kanë theksuar vazhdimisht nevojën për reforma strukturore në gjyqësor, përmirësim të efikasitetit, rritje të llogaridhënies dhe forcim të luftës kundër korrupsionit.

---

<sup>2</sup> Miratohet drafti i Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026 dhe propozim – vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik, Prishtinë 2021. <https://betimiperdrejtesi.com/miratohet-drafti-i-strategjise-per-sundimin-e-ligjit-2021-2026-dhe-propozim-vendimi-per-emerimin-e-anetareve-te-komisionit-per-njohjen-e-statusit-te-ish-te-denuarve-dhe-ish-te-perndjekurve-p/> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>3</sup> U.S. Embassy in Kosovo, deklaratë publike me rastin e prezantimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të RFSSL-së, 2021.

[https://www.facebook.com/photo.php?fbid=5675590145800427&set=a.287337823425278&type=3&ref=embed\\_post](https://www.facebook.com/photo.php?fbid=5675590145800427&set=a.287337823425278&type=3&ref=embed_post) (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>4</sup> EULEX Kosovo, reagim mbi strategjinë e sundimit të ligjit. <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,11,2430> Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

Sipas këtyre raporteve pritjet e BE nga RFSSL kane qenë të larta<sup>5</sup> dhe Strategjia për Sundimin e Ligjit është parë si instrumentet kryesore për adresimin e këtyre kërkesave në kuadër të procesit të integritimit evropian. Në veçanti, raportet për vendin kanë nënvizuar rëndësinë e implementimit më efektiv të strategjisë dhe jo vetëm miratimit formal të saj<sup>6</sup>, duke e lidhur drejtpërdrejt progresin në sundimin e ligjit me avancimin e Kosovës drejt BE-së.

Nga perspektiva e donatorëve, përfshirë USAID dhe projektet e ndryshme të mbështetjes në sektorin e drejtësisë, RFSSL është trajtuar si bazë për orientimin e investimeve dhe asistencës teknike. Përmes programeve shumëvjeçare, janë investuar miliona euro dhe dollarë në reforma që lidhen me efikasitetin e gjykatave, transparencën, digjitalizimin dhe forcimin e institucioneve të drejtësisë. Këto investime kanë qenë të lidhura ngushtë me pritjen që Strategjia për Sundimin e Ligjit të shërbejë si kornizë e qëndrueshme për koordinimin e reformave dhe për arritjen e rezultateve të matshme<sup>7</sup>.

Nga ana tjetër, shoqëria civile, përfshirë Institutin e Kosovës për Drejtësi, ka shprehur një mirëpritje të kujdesshme, duke mbajtur një qasje kritike ndaj përvojave të mëparshme me implementimin e dokumenteve strategjike. Organizatat vendore kanë theksuar se pritjet nuk lidhen më me hartimin e strategjive, por me zbatimin real të tyre, duke kërkuar mekanizma më të fortë monitorimi, transparencë dhe përfshirje aktive të aktorëve jo-qeveritarë në proceset e vlerësimit të progresit. Gjithashtu, është ngritur shqetësimi se, në mungesë të vullnetit politik dhe kapaciteteve të mjaftueshme administrative, ekziston rreziku që strategjia të mbetet deklarative dhe pa ndikim të prekshëm në përmirësimin e sundimit të ligjit<sup>8</sup>.

### ***Çfarë pritej të arrihej deri në vitin 2026***

Viti 2026 ishte projektuar si momenti i konsolidimit të reformës. Nëse Strategjia do të zbatohet plotësisht, sistemi i drejtësisë në Kosovë do të duhej të karakterizohej nga:

- një gjyqësor më efikas, me reduktim të ndjeshëm të lëndëve të pazgjidhura;

---

<sup>5</sup> Shih raportin për vendin të Komisionit Evropian për vitin 2020 faqe 5. Për më shumë shih [https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/kosovo_report_2020.pdf).

<sup>6</sup> Në raportin për vendin të vitit 2023, Komisioni Evropian vlerëson që strategjia e sundimit të ligjit është duke u zbatuar me hapa të ngadalshëm. Shih për më shumë raportin e KE për Kosovën të vitit 203 i qasshëm në: [https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SËD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SËD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf) Qasur për herë të fundit 10.05.2026).

<sup>7</sup> Shtetet e Bashkuara të Amerikës nëpërmjet programeve të mbështetura nga USAID ka përkrahur procese që zbatojnë rekomandime të parapara në strategjinë e sundimit të ligjit. Një nga programe ka qenë edhe programi për drejtësi komerciale i cili ka themeluar gjykatën komerciale dhe rritë numrin e lëndëve që zgjidhen nëpërmjet mekanizmave alternativ të kontesteve. Për më shumë për këtë program shih: <https://www.ruleoflawideas.org/wp-content/uploads/2025/08/Kosovo-Commercial-Justice.pdf> Qasur për herë të fundit 10.05.2026).

<sup>8</sup> Deklarata të Drejtorit Ekzekutiv të IKD <https://fokusi.info/miftaraj-vv-ja-ka-deshtuar-krejtësisht-ne-zbatimin-e-strategjise-per-sundim-te-ligjit/> si dhe raporti për dështimin e reformave në drejtësi ku IKD vlerëson që për shkak të veprimeve të Qeverisë, strategjia është e pa zbatueshme. Shih për më shumë raportin ‘Dështimi i reformave në drejtësi’ i qasshëm në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/12/The-Failure-of-the-Justice-Reform.pdf> Qasur për herë të fundit 10.05.2026).

- një sistem prokurorial më efektiv në ndjekjen e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar;
- mekanizma më të fortë të llogaridhënies dhe integritetit për gjyqtarët dhe prokurorët;
- qasje më e lehtë dhe më e barabartë në drejtësi për qytetarët;
- një sistem funksional i luftës kundër korrupsionit dhe konfiskimit të pasurisë.

Këto pritje nuk ishin vetëm aspirata politike, por ishin të lidhura drejtpërdrejt me indikatorë konkretë të performancës, të cilët duhej të matnin progresin e Strategjisë. Në këtë kuptim, viti 2026 nuk ishte thjesht fundi i një cikli strategjik, por një test i besueshmërisë së reformës në tërësi.

Megjithatë, gjetjet e IKD-së ndër vite tregojnë se këto pritje nuk janë përmbushur në praktikë. Që nga fillimi i zbatimit të Strategjisë, janë evidentuar probleme të vazhdueshme që lidhen me mospërputhjen ndërmjet planifikimit dhe zbatimit real të aktiviteteve, si dhe me mungesën e rezultateve konkrete në terren.

Në raportin për vitin 2022, IKD kishte konstatuar se, përkundër një paraqitjeje statistikore relativisht pozitive të zbatimit të aktiviteteve, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk ishin zbatuar në përputhje me Strategjinë. U evidentua se institucionet kishin ndërmarrë veprime që devijonin nga objektivat e SSL-së, ndërsa raportimi mbi zbatimin e aktiviteteve shpesh ishte i pasaktë dhe nuk reflektonte gjendjen reale në terren<sup>9</sup>.

Në të njëjtin raport, IKD kishte identifikuar raste konkrete ku aktivitetet ishin raportuar si të përmbushura apo pjesërisht të përmbushura, ndonëse në realitet nuk kishin prodhuar rezultatet e parapara. Kjo kishte krijuar një hendek të theksuar ndërmjet progresit të raportuar dhe progresit real, duke e vënë në pikëpyetje besueshmërinë e mekanizmave institucionalë të monitorimit.

Gjetjet e raportit për vitin 2023 konfirmuan vazhdimësinë e këtyre problemeve. IKD kishte konstatuar se zbatimi i Strategjisë vazhdonte me ritëm të ngadaltë dhe se mungesa e buxhetit adekuat përbënte një pengesë serioze për realizimin e aktiviteteve. Për më tepër, raportimi institucional vazhdonte të jetë i pasaktë, duke paraqitur një tablo më pozitive sesa realiteti i zbatimit.<sup>10</sup>

Një tjetër problem thelbësor i evidentuar në vitin 2023 ishte dështimi për të përmbushur obligimet procedurale të vetë Strategjisë. Mungesa e rishikimit afatmesëm dhe e miratimit të një plani të ri të veprimit brenda afateve të parapara kishte krijuar një vakuum në zbatim, duke e lënë Strategjinë pa mekanizma funksionalë për implementim.

Gjetjet e këtij raporti për vitin 2025 tregojnë se këto probleme jo vetëm që kanë vazhduar, por në disa raste janë thelluar edhe më tej. Në shumicën e objektivave strategjike dhe specifike dominojnë

<sup>9</sup> (Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë. <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjiise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>10</sup> STRATEGJIA NË UDHEKRYQ - (Raport monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Planit të Veprimit) <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-NE-UDHEKRYQ-Raporti-i-monitorimit-te-Strategjiise-per-Sundimin-e-Ligjit-dhe-Planit-te-Veprimit.pdf> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

aktivitetet e pazbatuara, ndërsa progresi është i kufizuar kryesisht në nivel formal, si hartimi i dokumenteve apo inicimi i proceseve, pa reflektim në rezultate konkrete<sup>11</sup>.

Në përfundim, IKD ka analizuar secilin objektiv strategjik dhe secilin objektiv specifik të Strategjisë për Sundimin e Ligjit, dhe gjetjet tregojnë qartë se pritjet për konsolidimin e reformës deri në vitin 2026 nuk janë arritur. Zbatimi i Strategjisë është karakterizuar nga mungesë e progresit të qëndrueshëm, raportim jo gjithmonë i saktë dhe një dominim i aktiviteteve të pazbatuara, duke e lënë reformën në sundimin e ligjit larg objektivave të saj fillestare.

## **5. Mos miratimi i Planit të Veprimit brenda afatit duke lënë një vit strategjinë të pazbatueshme**

Një nga dështimet më serioze në zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026 lidhet me mosmiratimin në kohë të Planit të Veprimit për periudhën pas vitit 2023, duke krijuar një vakuum njëvjeçar në zbatimin e Strategjisë. Ndërkohë që Strategjia parashihte qartë se zbatimi i saj duhet të bëhej përmes planeve të veprimit të strukturuar dhe të miratuara paraprakisht, mungesa e një plani të ri për vitin 2024 e ka bërë Strategjinë praktikisht të pazbatueshme gjatë kësaj periudhe.

Plani fillestar i Veprimit 2021–2023 përbënte instrumentin kryesor për zbatimin e objektivave strategjike, duke përfshirë qindra aktivitete të detajuara dhe të shpërndara ndërmjet institucioneve përgjegjëse.<sup>12</sup> Megjithatë, pas përfundimit të këtij plani, institucionet nuk kanë miratuar në kohë një plan të ri për vazhdimin e zbatimit të Strategjisë, edhe pse raportet e zbatimit kishin paraparë nevojën për rishikim dhe hartim të një plani të ri jo më larg se fillimi i vitit 2024.<sup>13</sup>

Si pasojë, gjatë vitit 2024, Strategjia ka funksionuar pa një kornizë operative, pa aktivitete të miratuara, pa afate konkrete dhe pa ndarje të përgjegjësive institucionale. Në mungesë të një Planit të Veprimit, institucionet zbatuese nuk kanë pasur bazë të qartë për implementim, monitorim dhe raportim, duke e reduktuar zbatimin e Strategjisë në veprime *ad hoc* dhe të pa koordinuara. Kjo situatë jo vetëm që ka ndikuar në ngadalësimin e reformave, por ka cenuar edhe integritetin e vetë kornizës strategjike të SSL, duke e shpëputur lidhjen ndërmjet objektivave dhe zbatimit praktik.

Problemi thellohet më tej nga fakti se Plani i ri i Veprimit 2025–2026 është miratuar vetëm në fund të muajit shkurt të vitit 2025, duke pretenduar retroaktivisht mbulimin e një periudhe që tashmë kishte kaluar pa asnjë kornizë zbatimi. Në praktikë, kjo nënkupton se për vitin 2024 nuk ka pasur asnjë aktivitet të planifikuar dhe të miratuar në kohë, duke e bërë këtë vit një periudhë të humbur në implementimin e Strategjisë.

---

<sup>11</sup> Shih më poshtë kapitullin IX – Monitorimi i zbatimit të SSL dhe të secilit objektiv strategjik.

<sup>12</sup> STRATEGJIA NË UDHEKRYQ - (Raport monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Planit të Veprimit) <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-NE-UDHEKRYQ-Raporti-i-monitorimit-te-Strategjise-per-Sundimin-e-Ligjit-dhe-Planit-te-Veprimit.pdf> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>13</sup> Raporti Vjetor për Zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, Prill 2024. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/08/STRATEGJISE-PER-SUNDIMIN-E-LIGJIT-2021-2026-RAPORTI-2023.pdf> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

Në tërësi, vonesa në miratimin e Planit të Veprimit reflekton një mungesë serioze të planifikimit strategjik dhe koordinimit institucional, duke minuar drejtpërdrejt zbatimin efektiv të Strategjisë për Sundimin e Ligjit. Një strategji pa plan veprimi nuk mund të prodhojë rezultate, dhe në këtë rast, mungesa e këtij instrumenti për një periudhë njëvjeçare përbën një dështim strukturor në menaxhimin e reformës së sundimit të ligjit.

## **6. Rishikimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit**

Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021–2026, e miratuar në korrik të vitit 2021 si produkt i procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL), i është nënshtruar një rishikimi afatmesëm gjatë vitit 2024, i cili është finalizuar dhe miratuar në shkurt të vitit 2025. Ky rishikim ishte i paraparë si mekanizëm për të vlerësuar progresin dhe për të rikalibruar ndërhyrjet e nevojshme drejt arritjes së objektivave strategjike deri në vitin 2026.

Procesi është zhvilluar nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe, formalisht, është mbështetur në analiza sektoriale dhe punë të grupeve ndërinstytucionale. Megjithatë, nga përmbajtja e dokumentit të rishikuar, rezulton se ky proces ka qenë më shumë procedural sesa substancial, pa reflektuar në mënyrë të plotë të dhënat ekzistuese mbi zbatimin e Strategjisë. Ndërhyrjet e propozuara, në thelb, ruajnë strukturën ekzistuese të Strategjisë dhe shtojnë një numër veprimesh të reja, pa demonstruar qartë se si këto ndërhyrje burojnë nga një analizë e mirëfilltë e performancës së deritanishme.

Pavarësisht pretendimeve për përmirësim të efektivitetit të Strategjisë, rishikimi afatmesëm i SSL-së paraqet mangësi serioze që e bëjnë atë një dokument me vlerë të kufizuar analitike dhe strategjike.

Së pari, rishikimi dështon të ofrojë një vlerësim të strukturuar dhe të bazuar në evidencë mbi nivelin real të zbatimit të Strategjisë. Për shembull, sipas raporteve vjetore të zbatimit, vetëm një pjesë e aktiviteteve është zbatuar plotësisht, ndërsa një përqindje e konsiderueshme ka mbetur në zbatim të pjesshëm ose e pazbatuar (p.sh. rreth 43% të zbatuara plotësisht, 45% pjesërisht dhe 12% të pazbatuara për periudhën 2021–2022). Megjithatë, këto gjetje nuk reflektohen në mënyrë të strukturuar në rishikimin afatmesëm, duke krijuar një hendek të qartë ndërmjet të dhënave faktike dhe analizës së paraqitur.

Së dyti, dokumenti nuk identifikon në mënyrë të qartë dhe të argumentuar pengesat strukturore dhe institucionale që kanë ndikuar në performancën e dobët të Strategjisë. Përkundër faktit që raportet vjetore të zbatimit identifikojnë në mënyrë eksplicite faktorë kyç si mungesa e koordinimit ndërinstytucional, mangësitë në planifikim dhe kufizimet në kapacitetet buxhetore dhe njerëzore, këto çështje nuk trajtohen në mënyrë substanciale në rishikim. Për shembull, Raporti Vjetor 2022 thekson se vonesat në zbatim lidhen drejtpërdrejt me “mungesën e koordinimit në mes të institucioneve zbatuese” dhe “mungesën e kapaciteteve buxhetore dhe njerëzore” (fq. 3).

Megjithatë, rishikimi afatmesëm nuk zhvillon një analizë të këtyre faktorëve dhe nuk i përkthen ato në masa konkrete korigjuese, duke reflektuar mungesë të një reflektimi kritik institucional mbi arsyet reale të moszbatimit.

Së treti, rishikimi nuk shfrytëzon në mënyrë adekuate mekanizmat ekzistues të monitorimit dhe raportimit. Strategjia kishte paraparë një sistem të rregullt monitorimi përmes raporteve gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe mekanizma institucionale për validimin e të gjeturave. Megjithatë, në dokumentin e rishikuar mungon integrimi sistematik i këtyre të dhënave në analizën strategjike. Për shembull, edhe pse raportet evidentojnë progres të pabarabartë ndërmjet objektivave (me performancë më të dobët në drejtësinë penale krahasuar me luftën kundër korrupsionit), këto dallime nuk reflektohen në prioritizimin e masave në rishikim. Si rezultat, dokumenti i rishikuar nuk ofron një pasqyrë të besueshme mbi atë që ka funksionuar dhe atë që ka dështuar.

Po ashtu duhet theksuar se miratimi i rishikimit ka ndodhur në një kontekst të paqëndrueshmërisë politike, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe legjitimitetin e procesit. Në vitin 2025, Kosova ka hyrë në zgjedhje nacionale, duke funksionuar për një periudhë me Qeveri në detyrë, që për një kohë të konsiderueshme një pjesë e madhe e anëtarëve të Qeverisë ka qëndruar kundërligjshëm në pozitën e anëtarit të qeverisë<sup>14</sup>, dhe pa Kuvend të konstituuar. Për më tepër, procesi i reformës në Drejtësi i iniciuar në mars të vitit 2024 ka shkaktuar mospajtime në mes të ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura të drejtësisë siç janë KGJK dhe KPK<sup>15</sup>. Kjo situatë ka kufizuar ndjeshëm mundësinë për debat dhe koordinim politik dhe mbikëqyrje institucionale mbi një dokument strategjik të kësaj rëndësie. Për më tepër, mekanizmat e paraparë në Strategji, si Komiteti Drejtues, organi më i lartë për mbikëqyrjen dhe validimin e zbatimit, i cili duhet të mblidhet së paku dy herë në vit dhe të vendosë për çështjet kyçe të zbatimit përkundër që ka mbajtur takime, nuk ka arritur të ndikojë në zbatimin efektiv të strategjisë. IKD nuk ka gjetur tek faqet e institucioneve përgjegjëse në Komitet Drejtues për mbajtjen e takimeve të Komitetit Drejtues gjatë kësaj periudhe, as njoftime apo raporte që do të dëshmonin funksionimin e tij. Ndryshe nga vitet 2022 dhe 2023, kur takimet e këtij Komiteti janë bërë publike, mungesa e transparencës e bën të pamundur vlerësimin e rolit dhe efektivitetit të tij në zbatim.

Në tërësi, rishikimi afatmesëm i SSL-së nuk arrin të përmbushë funksionin e tij kryesor si instrument për vlerësim dhe riorientim strategjik. Përkundrazi, ai reflekton një qasje formale të përditësimit të dokumentit, pa një analizë të thelluar të bazuar në evidencë dhe pa një përballje reale me problemet e zbatimit. Si i tillë, rishikimi nuk ofron një bazë të qëndrueshme për fazën e

---

<sup>14</sup> Moszbatimi i vendimeve gjyqësore - Paligjshmëria e Qeverisë Kurti dhe abuzimi me ushtrues detyre. <https://klics.org/wp-content/uploads/2025/09/Raporti-per-Qeverisje-te-kunderligjshme-dhe-UD-3.pdf> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>15</sup> Takime të përfaqësuesve të IKD me institucionet zbatuese të strategjisë të zhvilluara gjatë javës së dytë të muajit maj 2026

mbetur të zbatimit të Strategjisë dhe rrezikon të përsërisë të njëjtat mangësi strukturore që kanë karakterizuar periudhën e deritanishme.

## 7. Plani i Veprimit 2025-2026

Plani i Veprimit i Strategjisë së Sundimit të Ligjit 2025–2026<sup>16</sup>, i rishikuar dhe miratuar në shkurt 2025, në thelb përfaqëson më shumë një ristrukturim të masave ekzistuese sesa një agjendë të re reformuese. Analiza e veprimeve të përfshira në Planin e veprimit 2025-2026 përkundër Planit të veprimit 2021-2023 tregon se rreth 60% e veprimeve janë bartje ose riformulime, ndërsa vetëm një pjesë më e vogël janë veprime realisht të reja të dalta nga analizat e bëra siç potencohet në strategjinë e rishikuar.

Një nga problemet më të dukshme është mungesa e një lidhjeje të qartë me performancën dhe rezultatet, pasi shumica e veprimeve maten në “produkti/output” (miratim ligjesh, trajnime, dokumente), pa indikatorë të matshëm për efektet në efikasitet, qasje në drejtësi apo luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për shembull në kuadër të objektivit strategjik 1 janë mënjanuar makro indikatorët dhe është lënë vetëm indikator i indeksit të sundimit të ligjit i Programit të Drejtësisë Botërore (World Justice Program). Po ashtu nuk përshkruhet në analiza apo strategji se çfarë mundë të ndikojnë veprimet e propozuara në plan të veprimit në përmirësimin e sundimit të ligjit. Kjo reflekton mungesën e një analize substanciale të zbatimit të planit paraprak 2021–2026, duke e bërë planin aktual më shumë vazhdimësi administrative sesa korrigjim strategjik.

Strukturalisht, plani sjell disa ndryshime, si kalimi nga një qasje tematike në një fragmentim institucional dhe operacional të veprimeve, si dhe përfshirja e kapitullit të veçantë për digjitalizimin e drejtësisë (4.1), i cili nuk ka ekzistuar si i tillë në ciklin paraprak. Edhe pse Strategjia e rishikuar e trajton digjitalizimin si objektiv strategjik më vete, shumica e aktiviteteve të parapara fokusohen në zhvillimin e platformave, ndërlikohen e sistemeve apo avancimin teknik të infrastrukturës digjitale, pa përcaktuar qartë se si këto ndërhyrje do të ndikojnë në uljen e kohëzgjatjes së procedurave, reduktimin e *backlogut* të lëndëve apo përmirësimin e qasjes së qytetarëve në drejtësi. Për shembull, ndërlikohen e sistemit SMIL me sisteme të tjera përmendet si aktivitet, por nuk përcaktohen indikatorë konkretë të performancës që do të matnin efektin e këtij integrimi në efikasitetin e gjykatave dhe prokurorive.

Një dobësi edhe më kritike lidhet me aspektin financiar. Nga të gjitha veprimet e përfshira në Planin e veprimit të strategjisë së sundimit të ligjit 2025-2026 vetëm një pjesë shumë e kufizuar, vetëm disa në kapitullin e digjitalizimit, kanë të përcaktuar buxhet, ndërsa pjesa tjetër e veprimeve

---

<sup>16</sup> Vlen të theksohet se në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë plani i veprimit figuron i titulluar si PV 2024-2026, i miratuar në shkurt të vitit 2025.

janë pa kosto të specifikuar. Nga gjithsej 325<sup>17</sup> veprime të përfshira në Planin e Veprimit 2025–2026, 253 prej tyre nuk janë të buxhetuara, ndërsa vetëm 72 veprime kanë të përcaktuar koston financiare për zbatimin e tyre. Një çështje veçanërisht problematike, që bie ndesh me parimet bazë të hartimit të planeve të veprimit dhe me logjikën e planifikimit strategjik, është fakti se në kuadër të Planit të Veprimit ekzistojnë 9 veprime që kanë të paraparë kosto buxhetore për vitin 2024, ndonëse vetë aktivitetet janë të planifikuara për zbatim gjatë viteve 2025–2026. Kjo nënkupton se plani nuk shoqërohet me një vlerësim të mirëfilltë të ndikimit buxhetor, duke e bërë të paqartë se si dhe me çfarë burimesh do të realizohen masat e parapara, gjë që prapë mundë të ndikojë në nivelin e zbatimit të tyre.

Për më tepër kjo situatë nuk është vetëm problem teknik, por edhe çështje e përputhshmërisë ligjore. Sipas nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë, çdo dokument strategjik duhet të shoqërohet me një vlerësim të ndikimit financiar dhe implikimeve buxhetore. Në këtë kontekst, miratimi i Planit të Veprimit pa një buxhetim të qartë për shumicën e veprimeve vë në pikëpyetje përputhshmërinë e tij me kornizën rregullative në fuqi, duke sugjeruar se dokumenti mund të jetë miratuar pa përmbushur plotësisht standardet ligjore të kërkuara.

Një rrezik shtesë lidhet me mbivendosjen potenciale financiare me Planin e Rritjes së BE-së<sup>18</sup>. Mungesa e koordinimit dhe harmonizimit të financimit të veprimeve në kuadër të Planit të Veprimit 2025–2026 mund të çojë në situata të financimit të dyfishtë të aktiviteteve të njëjta, por edhe në rrezikun e mosdisbursimit të fondeve të Bashkimit Evropian. Ky rrezik bëhet edhe më i theksuar duke pasur parasysh se fondet e parapara në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së janë dukshëm më të mëdha sesa mjetet financiare të planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë. Për pasojë, mungesa e një koordinimi të qartë financiar dhe institucional mund të ndikojë negativisht si në realizimin e reformave të parapara, ashtu edhe në shfrytëzimin efektiv të mbështetjes financiare nga BE-ja. Reflektimi i krizës politike në zbatimin e Strategjisë

Kriza institucionale e vitit 2025 filloi pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit 2025, të cilat prodhuan një rezultat pa shumicë të qartë parlamentare. Për shkak të pamundësisë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe formimin e institucioneve të reja, vendi mbeti për muaj të tërë me Kuvend jo funksional dhe me Qeveri në detyrë. Kjo situatë ndikoi drejtpërdrejt në zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, veçanërisht duke pasur parasysh se vetë viti 2025 ishte viti i parë i zbatimit të Planit të ri të Veprimit 2025-2026, i cili përfshin 325 aktivitete konkrete dhe pesë objektiva kryesore: gjyqësorin dhe prokurorinë, drejtësinë penale, drejtësinë civile dhe administrative, digjitalizimin e drejtësisë dhe qasjen në drejtësi. Në këtë kontekst, konstatimet e Gjykatës Supreme për papajtueshmërinë e ushtrimit të njëkohshëm të funksionit të deputetit dhe atij të anëtarit të qeverisë kanë implikime të drejtpërdrejta edhe për funksionimin e mekanizmave

---

<sup>17</sup> Në Planin e Veprimit të miratuar janë të përfshira 325 veprime, ndërsa në dokumentin RISHIKIMI AFATMESËM I STRATEGJISË PËR SUNDIMIN E LIGJIT 2021-2026 theksohet se janë 317 aktivitete specifike. Ka një diskrepancë në shifrat e paraqitura në dokumentet zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>18</sup> Është parim i BE-së në kuadër të Planit të Rritjes se ato fusha të cilat i mbulon BE në kuadër të Planit, nuk mund të kenë financim nga donator tjerë.

të Strategjisë, përfshirë Komitetin Drejtues që udhëhiqet nga Ministri i Drejtësisë, duke e bërë situatën institucionale më të ndërlikuar dhe duke ngritur pikëpyetje për funksionimin efektiv të këtij mekanizmi gjatë kësaj periudhe.<sup>19</sup>

Një nga pasojat kryesore të krizës ishte vonesa në miratimin e legjislacionit të ri që lidhet me reformën në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Strategjia e rishikuar parasheh hartimin dhe miratimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Projektligjit për rekrutimin, vlerësimin e performancës, kontrollin e integritetit dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Miratimi i këtyre projektligjeve kërkon procedura të plota parlamentare, funksionim të komisioneve parlamentare dhe seanca plenare efektive, të cilat munguan gjatë pjesës më të madhe të vitit 2025.

Përveç këtyre projektligjeve, kriza institucionale ndikoi edhe në shtyrjen e një sërë reformash të tjera legjislative të parapara në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2025-2026. Këtu përfshihen hartimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës<sup>20</sup>, në mënyrë që vetëm kandidatët që nuk kanë qenë politikisht aktivë në tri vitet e fundit të mund të konsiderohen për anëtarësim në KGJK, si dhe hartimi i Projektligjit për Gjykatat bazuar në analizën për hartën e re gjyqësore. Po ashtu, u shtyn edhe hartimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Kriza ndikoi edhe në vonimin e reformave ligjore që lidhen me qasjen në drejtësi dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Në këtë drejtim, ndonëse u mbajtën punëtori nga ana e MD-së për hartimin e Ligjit të ri për Ndihmë Juridike Falas, i njëjti nuk u procedua për miratim në Qeveri ndërsa ndonëse përfundoi hartimi i Ligjit për Gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, dhe përkundër përfshirjes në Programin Legjislativ 2026-2028, i njëjti nuk u miratua në qeverinë e Kosovës për arsye së vendi shkoi në zgjedhje të parakohshme.<sup>21</sup>

Në fushën e drejtësisë penale dhe luftës kundër korrupsionit, bllokada institucionale ndikoi në shtyrjen e reformave që lidhen me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Kjo përfshin ndryshimin e legjislacionit për konfiskimin e pasurisë në mënyrë që një përqindje e të hyrave nga konfiskimi t'u ndahet institucioneve të sektorit të drejtësisë, si dhe hartimin e Ligjit për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Megjithatë, përtej vonesave në miratim, IKD ka evidentuar se procesi i hartimit dhe procedimit të Projektligjit për Byronë është karakterizuar nga tentativa për shmangie të procedurave të rregullta parlamentare, mungesë e konsultimeve publike dhe organizim arbitrar i tyre.<sup>22</sup> Konsultimi për këtë projektligj

---

<sup>19</sup> Supremja shfuqizon Udhëzimin Administrativ për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuereve Elektronikë Fiskalë. <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-shfuqizon-udhezimin-administrativ-per-shfrytezimin-e-pajisjeve-elektronike-fiskale-sistemeve-fiskale-dhe-softuereve-elektronike-fiskale/> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>20</sup> Aktiviteti 1, Kapitulli 1.1 i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2025-2026

<sup>21</sup> Aktiviteti 9, Kapitulli 5.1 i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2025-2026

<sup>22</sup> IKD: Kuvendi të mos shmangë procedurat për Projektligjin për Byronë. <https://kli-ks.org/ikd-kuvendi-te-mos-shmange-procedurat-per-projektligjin-per-byrone/> (Qasur për herë të fundit 03.05.2026).

është organizuar në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, përkatësisht pa respektuar afatin minimal prej pesë (5) ditësh për njoftim para mbajtjes së dëgjimit publik. Po ashtu, konsultimet janë zhvilluar me afate të shkurtuara dhe në mënyrë formale, duke kufizuar mundësinë për një trajtim përmbajtësor dhe gjithëpërfshirës të projektligjit.<sup>23</sup> Këto qasje bien ndesh me parimet e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe ligjshmërisë që promovon Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe legjitimitetin e reformave në këtë fushë.

Në të njëjtën kohë, mbeti pa përfunduar edhe hartimi i Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për AAPSK-në, përmes të cilit synohet rishikimi i kompetencave të kësaj agjencie.

Kriza pati ndikim edhe në fusha të tjera që ndërlidhen me drejtësinë civile dhe pronësore. Një nga aktivitetet që mbeti pa u finalizuar ishte Ligji për Tokën Ndërtimore, i cili ka rëndësi të veçantë për trajtimin e çështjeve pronësore dhe zhvillimin ekonomik. Po ashtu, vonesat në funksionalizimin e institucioneve ndikuan edhe në mungesën e mbështetjes financiare për sektorin e drejtësisë, përfshirë ndarjen e një buxheti më të madh për Akademinë e Drejtësisë, me qëllim rritjen e efikasitetit të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Blokada institucionale ndikoi edhe në funksionimin e Komitetit Drejtues të Strategjisë dhe mekanizmave të monitorimit të saj. Strategjia mbështetet në raportim të rregullt, koordinim ndërinstitutional dhe monitorim të vazhdueshëm të aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse. Në mungesë të institucioneve të plota dhe prioritizimit politik, një pjesë e konsiderueshme e energjisë institucionale duket se u zhvendos nga reformat në drejtësi drejt menaxhimit të krizës politike. Kjo ndikoi jo vetëm në vonimin e aktiviteteve konkrete, por edhe në dobësimin e koordinimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Kuvendit, KGJK-së, KPK-së dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë.

## 8. Buxheti i Strategjisë

IKD në raportet e veta për monitorimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit për vitet 2022 dhe 2023 ka gjetur se Strategjia dhe Plani i Veprimit janë zbatuar me ritëm të ngadaltë, ndërsa mungesa e buxhetit dhe e kapaciteteve ka qenë një nga pengesat kryesore për realizimin e aktiviteteve. Raportet kanë theksuar se vetëm një pjesë e vogël e mjeteve të planifikuara janë shpenzuar<sup>24</sup>, ndërsa aktivitetet më të kushtueshme kanë mbetur të pazbatuara.<sup>25</sup>

Në Rishikimin Afatmesëm të Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2025-2026, çështjes së buxhetit i është kushtuar vetëm një paragraf i shkurtër, më pak se gjysmë faqe, në të cilin thuhet se ndikimi

---

<sup>23</sup> IKD: Nuk marrim pjesë në konsultime formale për Projektligjin për Byronë. <https://kli-ks.org/ikd-nuk-marrim-pjese-ne-konsultime-formale-per-projektligjin-per-byrone/> (Qasur për herë të fundit 03.05.2026).

<sup>24</sup> (Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf> (Qasur për herë të fundit 03.05.2026).

<sup>25</sup> STRATEGJIA NË UDHEKRYQ - (Raport monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Planit të Veprimit). <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-NE-UDHEKRYQ-Raporti-i-monitorimit-te-Strategjise-per-Sundimin-e-Ligjit-dhe-Planit-te-Veprimit.pdf> (Qasur për herë të fundit 03.05.2026).

buxhetor dhe vlerësimi i nevojave financiare do të plotësohen pas konsultimeve publike. Dokumenti thekson se pas përfundimit të konsultimeve do të bëhet një vlerësim më i saktë i kostos së aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit, por në versionin final të rishikuar nuk jepen të dhëna konkrete për koston e reformave, burimet financiare apo institucionet që do t'i mbulojnë ato. Për një strategji që parasheh qindra aktivitete dhe reforma komplekse, trajtimi kaq i kufizuar i aspektit buxhetor tregon mungesë serioze të planifikimit financiar.

Përkundër faktit që Strategjia e rishikuar parasheh 325 aktivitete konkrete dhe përfshin reforma të shumta në sistemin gjyqësor, drejtësinë penale, drejtësinë civile dhe administrative, digjitalizimin dhe qasjen në drejtësi, dokumenti nuk shpjegon se cilat institucione do t'i mbulojnë kostot e këtyre reformave dhe në cilat linja buxhetore janë planifikuar ato. Në mungesë të këtij sqarimi, ekziston rreziku që një numër i madh i aktiviteteve të mbeten vetëm obligime në letër, pa mundësi reale për zbatim.

Kjo qasje përveç që është në kundërshtim me rregllativën në fuqi për miratimin e dokumenteve strategjike siç është shpjeguar më lartë, bie ndesh edhe me vetë parimet mbi të cilat është ndërtuar Strategjia për Sundimin e Ligjit. Strategjia parasheh një sinkronizim të plotë me dokumentet qeveritare të planifikimit të politikave dhe me dokumentet buxhetore. Kjo nënkupton që secili aktivitet dhe secila reformë duhet të ketë një mbështetje të qartë financiare, të paraparë paraprakisht në dokumentet buxhetore të institucioneve përgjegjëse. Në praktikë, kjo nuk ka ndodhur as në fazën e parë të Strategjisë dhe nuk as në rishikimin afatmesëm të saj.

Mungesa e planifikimit buxhetor është edhe më problematike kur merret parasysh se Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025 dhe Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026 parashohin qartë se për çdo nismë të re, përfshirë strategjitë dhe legjislacionin, organi propozues duhet të dorëzojë në Ministrinë e Financave Formularin për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor.<sup>26</sup> Ministria e Financave pastaj është e obliguar të bëjë vlerësimin e ndikimit në buxhet së paku për tri vitet e ardhshme fiskale. Megjithatë, nga dokumentet e Strategjisë së rishikuar nuk rezulton se një vlerësim i tillë është bërë apo se është integruar në mënyrë të qartë në dokumentet buxhetore.

Po ashtu, në pjesën tekstuale të ligjeve për ndarjet buxhetore për vitet 2025 dhe 2026, Strategjia për Sundimin e Ligjit nuk përmendet fare si dokument specifik strategjik që kërkon financim. Emërtimi i saj nuk figuron as në pjesën e aneksit të performancës sipas sektorëve të politikave dhe as në pjesën ku përshkruhen dokumentet strategjike të Ministrisë së Drejtësisë.<sup>27</sup>

Mungesa e një kornize të qartë financiare përveç që rrezikon zbatimin e strategjisë në tersi, rrezikon drejtpërdrejt edhe realizimin e aktiviteteve më të kushtueshme dhe më komplekse të Strategjisë. Kjo përfshin reformën e sistemit të rekrutimit dhe vlerësimin të gjyqtarëve dhe

---

<sup>26</sup> Neni 17, Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2026, Prishtinë 2026. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=117682> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>27</sup> Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2026, fq. 678, Prishtinë 2026. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=117682> (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

prokurorëve, digjitalizimin e drejtësisë, forcimin e sistemit të ndihmës juridike falas, rritjen e kapaciteteve të Akademisë së Drejtësisë, si dhe funksionalizimin e mekanizmave të rinj për konfiskimin e pasurisë dhe luftën kundër korrupsionit. Në mungesë të financimit, këto reforma rrezikojnë të pësojnë fatin e njëjtë si aktivitetet e pazbatuara të periudhës 2021-2023.

Për më tepër, mungesa e planifikimit financiar dobëson edhe funksionimin e mekanizmave të monitorimit dhe koordinimit të Strategjisë. Komiteti Drejtues, organi koordinues ndërinstitucional dhe Sekretariati kanë përgjegjësi të rëndësishme për mbikëqyrjen dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë. Megjithatë, nëse institucionet përgjegjëse nuk kanë qartësi se cilat mjete financiare do të jenë në dispozicion dhe nga cilat burime do të financohen aktivitetet, monitorimi i zbatimit mbetet formal dhe i shkëputur nga realiteti financiar.

Në përfundim, rishikimi afatmesëm i Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2025-2026 ka ruajtur të njëjtin problem themelor që është evidentuar edhe në raportet paraprake, mungesën e një planifikimi të qartë buxhetor. Edhe pse Strategjia parasheh reforma të shumta dhe aktivitete konkrete, ajo nuk tregon se si do të financohen ato, nga cilat institucione do të sigurohen mjetet dhe në cilat dokumente buxhetore janë planifikuar. Për këtë arsye, ekziston rreziku serioz që edhe kjo fazë e Strategjisë të përballet me të njëjtat pengesa që kanë karakterizuar periudhën paraprake të zbatimit.

## **9. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit**

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit për vitin 2025 tregon se progresi në realizimin e objektivave strategjike dhe specifike ka qenë i ndryshëm ndërmjet sektorëve të ndryshëm të drejtësisë. Në një pjesë të konsiderueshme të fushave janë evidentuar vonesa në realizimin e aktiviteteve të parapara, ndërsa në disa fusha janë shënuar disa zhvillime, sidomos në aspektin e hartimit të projektligjeve, konsultimeve publike, funksionalizimit të mekanizmave institucionale dhe avancimit të sistemeve elektronike. Në këtë kontekst, duhet pasur parasysh se viti 2025 është karakterizuar nga mungesa e një Qeverie me mandat të plotë dhe moskonstituimi i Kuvendit për një periudhë të konsiderueshme kohore, rrethana këto që kanë ndikuar drejtpërdrejt në procedimin, miratimin dhe zbatimin e një pjese të reformave dhe aktiviteteve të parapara me Strategjinë për Sundimin e Ligjit.

Në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, progresi ka qenë i kufizuar, veçanërisht në aspektin e reformave ligjore, transparencës dhe efikasitetit procedural. Një pjesë e aktiviteteve kyçe kanë avancuar në nivel të hartimit, konsultimeve publike dhe procedimit institucional, mirëpo shumica e tyre nuk janë finalizuar gjatë vitit 2025.

Në fushën e rekrutimit, integritetit dhe zhvillimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë ndërmarrë hapa në drejtim të hartimit të reformave dhe zhvillimit të dokumenteve përkatëse, megjithatë një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve kanë mbetur në faza fillestare ose janë shtyrë për periudhën pasuese.

Sa i përket drejtësisë penale, progresi ka qenë i pabarabartë. Në disa fusha, si ekzekutimi i sanksioneve penale, janë evidentuar zhvillime në aspektin e trajnimeve, programeve rehabilituese dhe bashkëpunimit ndërinstytucional, ndërsa në fusha të tjera, si drejtësia për të mitur dhe sekuestrimi e konfiskimi i pasurisë, progresi ka qenë më i kufizuar.

Në drejtësinë civile, komerciale dhe administrative janë evidentuar disa zhvillime pozitive, përfshirë funksionalizimin e Gjykatës Administrative, organizimin e trajnimeve dhe avancimin e sistemeve elektronike. Megjithatë, një pjesë e aktiviteteve strategjike kanë mbetur të pazbatuara ose janë realizuar vetëm pjesërisht gjatë vitit 2025.

Në fushën e digjitalizimit të drejtësisë dhe profesioneve të lira janë evidentuar zhvillime konkrete në funksionalizimin e disa sistemeve elektronike, organizimin e trajnimeve dhe avancimin e akteve profesionale dhe etike. Megjithatë, progresi i përgjithshëm është ndikuar nga vonesat në miratimin e disa reformave ligjore dhe mosrealizimi i plotë i aktiviteteve të parapara.

Në fund, edhe në fushën e qasjes në drejtësi, bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe komunikimit me publikun janë evidentuar aktivitete vetëdijësuese, konsultime publike dhe forma të bashkëpunimit institucional. Megjithatë, zbatimi i aktiviteteve në këto fusha ka qenë jo i njëtrajtshëm dhe një pjesë e mekanizmave të planifikuar nuk janë funksionalizuar plotësisht gjatë vitit 2025.

IKD ka analizuar secilin objektiv strategjik, secilin objektiv specifik dhe secilin institucion përgjegjës lidhur me nivelin e zbatimit të aktiviteteve të parapara në Strategjinë për Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimit 2025–2026. Gjetjet tregojnë qartë se zbatimi i Strategjisë gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga mungesë e progresit të qëndrueshëm, dominim i aktiviteteve të pazbatuara dhe rezultate të kufizuara në praktikë.

## **10. Përmbushja e veprimeve sipas objektivave strategjike dhe sipas institucioneve përgjegjëse**

Analiza e nivelit të zbatimit të aktiviteteve sipas institucioneve përgjegjëse tregon dallime të konsiderueshme ndërmjet institucioneve sa i përket realizimit të aktiviteteve të parapara në Strategjinë për Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimit 2025–2026. Në përgjithësi, institucionet kanë shënuar progres më të dukshëm në aktivitetet që ndërlidhen me trajnimet, digjitalizimin dhe bashkëpunimin institucional, ndërsa niveli më i ulët i zbatimit është evidentuar në aktivitetet që kërkonin reforma ligjore, koordinim ndërinstytucional, miratim të politikave dhe angazhim buxhetor.

Nr.	Institucioni	Të zbatuara	Pjesërisht	Të pazbatuara	Gjithsej aktivite
1	Ministria e Drejtësisë	32	7	59	98
2	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	11	11	9	31
3	Këshilli Prokurorial i Kosovës	8	5	2	15
4	Kuvendi i Kosovës	1	0	2	3
5	Byroja Shtetërore për VKPP	0	0	1	1
6	Shërbimi Korrektues i Kosovës	7	2	3	12
7	Shërbimi Sprovues i Kosovës	0	1	4	5
8	Policia e Kosovës	1	0	1	2
9	Akademia e Drejtësisë	20	2	3	25
10	Oda e Avokatëve të Kosovës	2	1	2	5
11	Oda e Noterëve	1	0	0	1
12	Oda e Përmbaaruesve Privatë	1	0	0	1
13	Oda e Administratorëve të Falimentit të Kosovës	1	0	1	2
14	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	2	0	1	3
15	Qeveria e Kosovës / Zyra e Kryeministrit	1	0	1	2
16	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1	0	0	1
17	Ministria e Punëve të Brendshme	1	1	6	8
18	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	2	0	0	2
19	Ministria e Shëndetësisë	0	0	1	1

<b>TOTALI</b>	<b>92</b>	<b>30</b>	<b>96</b>	<b>218</b>
---------------	-----------	-----------	-----------	------------

**Tabela 1. Niveli i zbatimit të aktiviteteve sipas institucioneve përgjegjëse gjatë vitit 2025**

Ministria e Drejtësisë rezulton institucioni me numrin më të madh të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit 2025–2026. Megjithëse MD ka realizuar një numër aktivitete, ajo njëkohësisht ka pasur edhe numrin më të madh të aktiviteteve të pazbatuara, veçanërisht në fushën e reformës ligjore, digjitalizimit, profesioneve të lira dhe bashkëpunimit me publikun dhe shoqërinë civile. Një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve kanë mbetur në fazë të hartimit ose konsultimeve publike pa u finalizuar gjatë vitit 2025.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka shënuar progres më të dukshëm krahasuar me shumicën e institucioneve tjera, sidomos në aspektin e digjitalizimit, interoperabilitetit institucional dhe funksionalizimit të Gjykatës Administrative. Po ashtu, KGJK ka realizuar një numër aktivitete që ndërlidhen me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe efikasitetin procedural. Megjithatë, një pjesë e aktiviteteve kanë mbetur pjesërisht të zbatuara ose të pazbatuara, veçanërisht në raport me unifikimin e praktikës gjyqësore dhe zhvillimin e mekanizmave monitorues.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka realizuar një pjesë të aktiviteteve që ndërlidhen me zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale, megjithatë progresi mbetet më i kufizuar në

raport me disa objektiva strategjike, sidomos në aktivitetet që kërkonin koordinim të gjerë institucional dhe reforma procedurale.

Akademia e Drejtësisë rezulton ndër institucionet me nivelin më të lartë të realizimit të aktiviteve, kryesisht në organizimin e trajnimeve dhe programeve profesionale për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të sektorit të drejtësisë. Në anën tjetër, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka shënuar progres të pjesshëm, veçanërisht në aktivitetet që lidhen me trajnimet, programet rehabilituese dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, ndërsa një pjesë e aktiviteve strategjike dhe infrastrukurore kanë mbetur të pazbatuara.

Institucionet tjera, përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Sprovues të Kosovës, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas dhe odat profesionale, kanë pasur nivel më të kufizuar të aktiviteve të parapara në Planin e Veprimit, me progres të pjesshëm dhe të pabarabartë në zbatim.

Në përgjithësi, analiza sipas institucioneve tregon se niveli i zbatimit të aktiviteve ka qenë i pabarabartë dhe i ndikuar nga mungesa e koordinimit institucional, kapaciteteve administrative dhe zhvillimeve politike gjatë vitit 2025. Një pjesë e konsiderueshme e aktiviteve kanë mbetur të pazbatuara ose janë realizuar vetëm pjesërisht, duke reflektuar sfida të vazhdueshme në zbatimin efektiv të Strategjisë për Sundimin e Ligjit.

### **Objektivi Strategjik 1: Gjyqësori dhe prokuroria efikase, profesionale dhe me integritet**

#### **Objektivi Specifik 1: Efikasiteti, transparenca dhe disiplina në sistemin gjyqësor dhe prokurorial**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 19 aktivitete, nga të cilat vetëm 3 janë zbatuar plotësisht, 6 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 10 nuk janë zbatuar fare. Kjo nënkupton se vetëm rreth 16% e aktiviteve janë realizuar plotësisht gjatë vitit 2025. Nga aktivitetet e pazbatuara gjatë vitit 2025, katër janë zbatuar plotësisht dhe dy pjesërisht gjatë vitit 2026, kryesisht në aspektin e hartimit të projektligjeve dhe inicimit të procedurave institucionale.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i kufizuar dhe shumica e aktiviteve të planifikuara nuk janë realizuar brenda afateve të parapara. Disa aktivitete kanë filluar të adresohen vetëm gjatë vitit 2026, ndërsa në disa të tjera janë evidentuar zhvillime konkrete, të cilat nuk kanë rezultuar me përfundimin e aktiviteve brenda afateve të parapara.<sup>28</sup>

Në aspektin legjislativ, projektligjet për KGJK-në, KPK-në, Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Ligji për Ndihmë Juridike Falas, nuk janë miratuar gjatë vitit 2025. Një pjesë e tyre janë hartuar gjatë vitit 2026, ndërsa vonesat janë ndërlikuar edhe me

---

<sup>28</sup> Për efekte të këtij raporti, vetëm aktivitetet e planifikuara në 2025 janë subjekt i trajtimit dhe cdo veprim i ndërmarrë në vitin 2026 nuk do të trajtohet në këtë raport.

mosfunktionalizimin e Kuvendit dhe Qeverisë gjatë vitit 2025. Për Projektligjin për Ndhimë Juridike Falas, gjatë vitit 2025 janë mbajtur tre punëtori të grupit punues dhe është finalizuar drafti i projektligjit<sup>29</sup>. Po ashtu, plotësimi i përbërjes së KGJK-së me anëtarin jo-gjyqësor nuk është realizuar gjatë vitit 2025, ndonëse procesi është finalizuar në vitin 2026.<sup>30</sup>

Në aspektin e transparencës dhe komunikimit publik, KGJK dhe KPK nuk kanë zhvilluar fushata të mirëfillta informuese për sistemin e përgjegjësive disiplinore. KPK ka deklaruar se aktiviteti është realizuar pjesërisht përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe diskutime me akterë institucionalë dhe organizata të shoqërisë civile. Po ashtu, KPK ka ridizajnuar dhe përditësuar ueb-faqen zyrtare, ku publikohen dokumente dhe materiale të ndryshme, përfshirë edhe vendimet disiplinore të KPK-së dhe të Autoritetit Kompetent.<sup>31</sup> Megjithatë, transparenca mbetet e kufizuar në raport me të gjitha kërkesat e parapara në Planin e Veprimit. Ndërsa, udhëzimet për përdorimin e mediave sociale dhe komunikimin publik nga prokuroritë nuk janë miratuar gjatë vitit 2025, ndonëse sipas KPK-së ato janë hartuar dhe kanë mbetur në pritje të procedimit për miratim.

Në raport me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe disiplinën, Akademia e Drejtësisë nuk ka realizuar trajnimet e parapara për menaxhim dhe udhëheqje për kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët. Sipas komenteve të Akademisë së Drejtësisë, mungesa e trajnerëve dhe kapaciteteve profesionale ka ndikuar në mosrealizimin e këtyre aktiviteteve, ndërsa janë zhvilluar diskutime me partnerë ndërkombëtarë për standardizimin e trajnimeve në të ardhmen. Për trajnimet për kryeprokurorët është evidentuar se aktiviteti është realizuar pjesërisht, duke pasur parasysh se trajnime të ngjashme janë mbajtur në vitet paraprake.

Në aspektin e efikasitetit procedural, KGJK ka përgatitur raportin lidhur me produktivitetin e seancave gjyqësore dhe ka vazhduar promovimin e rasteve të suksesshme gjyqësore në platformat e komunikimit publik. Megjithatë, aktivitetet që lidhen me krijimin e mekanizmave për skanimin e hershëm të lëndëve dhe rritjen e masave ndaj dështimit të seancave gjyqësore nuk janë realizuar plotësisht. Për aktivitetin që lidhet me gjobat dhe masat ndaj palëve për mungesë në seanca, KGJK ka deklaruar se raportet përmbajnë të dhëna për këto masa, por mungojnë statistika të detajuara, për çka aktiviteti është vlerësuar si pjesërisht i zbatuar.

Po ashtu, nuk është arritur koordinim i plotë ndërmjet KGJK-së dhe Zyrës së Gazetës Zyrtare për përkthimin e akteve gjyqësore. Zyra e Kryeministrit ka deklaruar se janë zhvilluar takime, trajnime

---

<sup>29</sup> IKD ka zhvilluar takime me institucionet respektive dhe nga të dhënat e pranuar në këto takime, janë paraqitë gjetjet në raport.

<sup>30</sup> Bashkim Hyseni dhe Ivana Milenković zgjidhen anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dështon zgjedhja për një vend tjetër <https://betimiperdrejtesi.com/bashkim-hyseni-dhe-ivana-milenkovic-zgjidhen-anetare-te-keshillit-gjyqesor-te-kosoves-deshton-zgjedhja-per-nje-vend-tjeter/> (Qasur për herë të fundit 10.05.2026).

<sup>31</sup> Materiale që ndërlidhen me përgjegjësinë, disiplinën dhe llogaridhënien e prokurorëve të shtetit, përfshirë edhe vendimet e ndryshme lidhur me disiplinimin e prokurorëve. Sistemi Prokurorial, 2026. <https://prokuroria-rks.org/documents?documentTypeId=40> (Qasur për herë të fundit 10.05.2026).

dhe punëtori koordinuese me gjykatat gjatë vitit 2025, ndërsa KGJK ka vlerësuar se aktiviteti ende nuk ka gjetur zbatim të plotë. Për këtë arsye, aktiviteti është konsideruar si pjesërisht i zbatuar.

**Konkluzion:** *Progresi në këtë objektiv ka qenë i kufizuar dhe kryesisht formal. Shumica e aktiviteteve që kërkojnë reforma ligjore, koordinim institucional, transparencë dhe masa konkrete për rritjen e efikasitetit procedural nuk janë realizuar brenda afateve të parapara, ndërsa një pjesë e aktiviteteve janë zhvilluar vetëm pjesërisht ose kanë mbetur në nivel të hartimit dhe diskutimeve institucionale.*

**Objektivi Specifik 2: Rekrutimi, vlerësimi i performancës, kontrolli i integritetit, avancimi, statusi dhe zhvillimi profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve**

Për vitin 2025 në kuadër të objektivit 2 të Strategjisë së Sundimit të Ligjit kanë qenë të planifikuara 22 aktivitete. Nga monitorimi i IKD-së dhe bazuar në të dhënat e hapura, rezulton se 7 aktivitete janë zbatuar plotësisht, 2 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 13 aktivitete nuk janë zbatuar fare, apo mbi 59% e aktiviteteve të planifikuara nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.

Progresi në këtë objektiv ka qenë i kufizuar dhe shumica e aktiviteteve nuk janë realizuar brenda afateve të parapara. Megjithatë, në disa aktivitete janë evidentuar zhvillime konkrete, veçanërisht në aspektin e planifikimit të burimeve njerëzore, trajnimeve dhe zhvillimit të platformave elektronike për trajnim.

Në aspektin legjislativ, projektligji për rekrutimin, vlerësimin e performancës, kontrollin e integritetit dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe projektligji për Akademinë e Drejtësisë nuk janë miratuar gjatë vitit 2025. Sipas informatave të pranuar nga takimet që IKD ka zhvilluar me institucionet përgjegjëse, këto projektligje kanë qenë të hartuara që nga viti 2024 dhe janë dërguar për opinion në Komisionin e Venecias gjatë muajit dhjetor 2024. Pas pranimin të opinionëve të Komisionit të Venecias, vetëm gjatë vitit 2026 MD ka iniciuar rocesin e rishikimit të këtyre ligjeve. Ndërkaq, Ligji për KPK-në është miratuar dhe ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2025, duke adresuar synimet për të cilat është iniciuar plotësim ndryshimi i tije kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve.

Në aspektin e planifikimit të burimeve njerëzore dhe rekrutimin e prokurorëve dhe stafit mbështetës, KPK ka hartuar dokumente planifikuese lidhur me nevojat për rekrutim dhe zhvillim profesional të prokurorëve dhe stafit mbështetës, duke përfshirë planifikimin e personelit dhe programet trajnuese për vitin 2026. Ndërkaq, aktivitetet që lidhen me reformën e sistemit të rekrutimit dhe avancimit, përfshirë ndryshimet ligjore dhe krijimin e mekanizmave të ankesës në Gjykatën Supreme për kandidatët, nuk janë finalizuar gjatë vitit 2025, ndonëse projektligjet përkatëse janë hartuar dhe kanë kaluar në fazën e konsultimeve publike. Mosmiratimi i tyre lidhet edhe me mosfunksionalizimin e Qeverisë dhe Kuvendit gjatë vitit 2025.

Në raport me zhvillimin profesional, Akademia e Drejtësisë ka realizuar një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara. Janë rishikuar programet e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë, ndërsa janë realizuar edhe trajnime të specializuara për gjyqtarë në fushat e identifikuara nga vlerësimi i performancës. Po ashtu, është zgjeruar përdorimi i platformës elektronike të trajnimeve përmes platformës HELP dhe moduleve online të trajnimit.

Në aspektin e integritetit dhe barazisë gjinore, aspekti gjinor është përfshirë në trajnimet në fushën kundër diskriminimit dhe trajnimet për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave. Megjithatë, nuk është organizuar tryeza e përbashkët ndërinstucionale për trajtimin e krimit kibernetik me bazë gjinore.

Sa i përket burimeve financiare, rritja e buxhetit për Akademinë e Drejtësisë ka qenë minimale dhe nuk përmbush objektivin e paraparë për forcimin e kapaciteteve të trajnimit. Buxheti i Akademisë së Drejtësisë është rritur vetëm për 1,728 euro krahasuar me vitin paraprak, çka nuk reflekton prioritet institucional për këtë fushë.

Po ashtu, Plani i Integritetit institucional nuk është miratuar gjatë vitit 2025, ndonëse është raportuar koordinim ndërinstucional lidhur me aktivitetet e verifikimit.

***Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Edhe pse janë evidentuar zhvillime konkrete në aspektin e trajnimeve, planifikimit dhe platformave elektronike, shumica e aktiviteteve kyçe që lidhen me reformën legjislative, rekrutimin, avancimin dhe mekanizmat institucionale të integritetit nuk janë realizuar brenda afateve të parapara.***

## **Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i sistemit të Drejtësisë Penale**

### **Objektivi Specifik 1: Funkcionimi i Policisë së Kosovës**

Në vitin 2025 ishin planifikuar 4 aktivitete, prej të cilave 2 janë zbatuar plotësisht, ndërsa 2 nuk janë zbatuar fare.

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Në aspektin e ngritjes së integritetit dhe etikës profesionale, Policia e Kosovës dhe Akademia për Siguri Publike kanë realizuar trajnimet e etikës për zyrtarët policorë dhe mbikëqyrësit. Trajnimet janë zhvilluar përmes programeve të Akademisë për Siguri Publike dhe kanë përfshirë tema që lidhen me etikën policore, Kodin e Etikës dhe dilemat profesionale në ushtrimin e detyrës.

Megjithatë, nuk janë organizuar tryeza të përbashkëta ndërinstucionale ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit për përmirësimin e hetimeve në rastet e dhunës në familje dhe inicimin

e rasteve nga Drejtoria për Hetimin e Brendshëm. Po ashtu, nuk është hartuar metodologjia për kontrollin e brendshëm dhe iniciimin e rasteve nga Drejtoria për Hetimin e Brendshëm.

**Konkluzion:** *Në këtë objektiv është shënuar progres i kufizuar, kryesisht në aspektin e trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale, ndërsa aktivitetet që lidhen me koordinimin ndërinstytucional dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.*

#### **Objektivi Specifik 2: Funkcionimi i prokurorisë dhe gjykatave në trajtimin e rasteve penale**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 9 aktivitete, prej të cilave vetëm dy janë zbatuar, dy janë zbatuar pjesërisht, ndërsa pesë nuk janë zbatuar fare që përbën rreth 56% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.*

Në aspektin normativ, një pjesë e udhëzimeve dhe rregulloreve që ndërlidhen me trajtimin e rasteve penale nuk janë hartuar ose nuk janë miratuar. Disa prej këtyre aktiviteteve janë zbatuar pjesërisht rrjedhimisht nuk kanë prodhuar efekt në praktikë.

Në raport me trajtimin e rasteve penale, nuk janë krijuar mekanizmat dhe grupet punuese të parapara për hetimin dhe koordinimin e rasteve, ndërsa mungojnë zhvillime konkrete në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe gjykatave.

Në anën tjetër, janë evidentuar disa aktivitete të realizuara, si mbajtja e trajnimeve dhe përgatitja e raporteve të caktuara, ndërsa disa aktivitete janë zbatuar vetëm pjesërisht.

**Konkluzion:** *Progresi në këtë objektiv ka qenë i kufizuar, me shumicën e aktiviteteve të pazbatuara dhe pa ndikim të dukshëm në përmirësimin e trajtimit të rasteve penale.*

#### **Objektivi Specifik 2: Funkcionimi i prokurorisë dhe gjykatave në trajtimin e rasteve penale**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 9 aktivitete, prej të cilave 2 janë zbatuar plotësisht, 2 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 5 nuk janë zbatuar fare, që përbën rreth 56% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i kufizuar, me shumicën e aktiviteteve të pazbatuara ose të realizuara vetëm pjesërisht. Në aspektin normativ, janë miratuar disa udhëzime dhe rregullore që ndërlidhen me funksionimin e sistemit prokurorial, përfshirë udhëzimet administrative dhe rregulloret për organizimin e brendshëm në KPK. Megjithatë, një pjesë e aktiviteteve ligjore dhe procedurale nuk janë finalizuar gjatë vitit 2025.

Në raport me koordinimin institucional dhe trajtimin e rasteve penale, nuk janë krijuar grupet punuese të parapara për hetimin dhe koordinimin e rasteve ndërmjet institucioneve, ndërsa

mungojnë zhvillime konkrete në funksionalizimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe gjykatave.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimet e specializuara për gjyqtarë dhe prokurorë në fushën e hetimit financiar, konfiskimit dhe luftimit të krimit të organizuar. Po ashtu, janë përgatitur raporte të caktuara lidhur me analizën e rasteve penale dhe funksionimin e sistemit prokurorial.

Megjithatë, nuk janë miratuar ndryshimet ligjore që ndërlidhen me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe, ndërsa disa veprime kanë mbetur vetëm në fazën e draftimit apo konsultimeve pa prodhuar rezultate konkrete në praktikë.

**Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm dhe i kufizuar. Edhe pse janë realizuar disa aktivitete në aspektin normativ dhe të trajnimeve profesionale, shumica e aktiviteteve që lidhen me koordinimin institucional, mekanizmat hetimorë dhe reformën procedurale penale nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.**

### **Objektivi Specifik 3: Funksionimi i drejtësisë për të mitur**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 12 aktivitete, prej të cilave 3 janë zbatuar plotësisht, 4 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 5 nuk janë zbatuar fare, që përbën rreth 42% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm, me zhvillime të kufizuara kryesisht në aspektin e raportimit, trajnimeve dhe koordinimit institucional, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.

Në aspektin e trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin, janë evidentuar zhvillime të pjesshme lidhur me masat e diversitetit. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka nxjerrë udhëzues të veçantë për shqiptimin e këtyre masave, megjithatë ka mbështetur organizatat joqeveritare dhe UNICEF-in në hartimin e procedurave standarde të veprimit dhe formularëve për shqiptimin e masës së diversitetit. Po ashtu, në mekanizmat raportues të kryeprokurorëve janë përfshirë edhe të dhënat për numrin e masave të diversitetit të shqiptuara.

Në raport me koordinimin institucional, janë mbajtur disa takime ndërmjet prokurorisë, gjykatave, shërbimit sprovues dhe mekanizmave të tjerë lokalë për trajtimin e rasteve të të miturve, megjithëse këto takime nuk janë zhvilluar në mënyrë të rregullt. Gjithashtu, edhe procesi i unifikimit të praktikës gjyqësore për masat edukative ka mbetur në zhvillim e sipër.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimet për gjyqtarët lidhur me trajtimin e rasteve civile që ndërlidhen me të drejtat e fëmijëve, përfshirë

dhunën në familje, marrëdhëniet familjare me element ndërkombëtar dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ndërkaq, lidhur me trajnimet për avokatët, janë evidentuar zhvillime të pjesshme.

Megjithatë, një numër i konsiderueshëm aktivitetesh nuk janë realizuar gjatë vitit 2025. Nuk janë përgatitur studimet dhe raportet e parapara lidhur me faktorët kriminogjen tek fëmijët dhe Programin për Mbrojtjen e Fëmijës nën moshën e përgjegjesisë penale. Po ashtu, nuk janë organizuar trajnimet për punëtorët socialë dhe nuk janë evidentuar zhvillime në prioritizimin e drejtësisë për fëmijë në planet institucionale.

**Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Edhe pse janë realizuar disa aktivitete në aspektin e trajnimeve, raportimit dhe koordinimit institucional, shumica e aktiviteteve strategjike që lidhen me zhvillimin e politikave, analizave dhe mekanizmave të qëndrueshëm për drejtësinë për të mitur nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.**

#### **Objektivi specifik 4: Ekzekutimi i sanksioneve penale**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 27 aktivitete, prej të cilave 9 janë zbatuar plotësisht, 7 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 11 nuk janë zbatuar fare, që përbën rreth 41% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit. Nga aktivitetet e pazbatuara gjatë vitit 2025, një pjesë kanë vazhduar të adresohen gjatë vitit 2026 përmes draftimit të dokumenteve dhe zhvillimit të aktiviteteve përgatitore.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm, me zhvillime më të dukshme në aspektin e trajnimeve, programeve rehabilituese, planifikimit individual të dënimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet SHKK-së, SHSK-së, IPFK-së dhe Departamentit Shëndetësor të Burgjeve. Gjatë vitit 2025 janë organizuar trajnime dhe punëtori të përbashkëta me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe EULEX-it, janë zhvilluar aktivitete rehabilituese dhe aftësimi profesional për personat e dënuar, si dhe është hartuar draft-udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të planit individual të dënimit. Megjithatë, një numër aktivitetesh strategjike kanë mbetur të pazbatuara.

Në aspektin normativ dhe organizativ, është miratuar Rregullorja për strukturën dhe organizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa janë ndërmarrë hapa edhe për rishikimin e kurrikulave të trajnimit profesional për zyrtarët korrektues. Po ashtu, janë miratuar programe të reja rehabilituese për përgatitjen për lirim dhe trajtimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, ndërsa ka filluar edhe finalizimi i programit për trajtimin e varësisë nga droga.

Në raport me zhvillimin e kapaciteteve profesionale, janë realizuar një numër trajnimesh ndërinstytucionale për personelin korrektues dhe shëndetësor, përfshirë trajnimet mbi dokumentimin e keqtrajtimit sipas Protokollit të Stambollit<sup>32</sup>, trajtimin e personave transgjiorë të

---

<sup>32</sup> **Protokolli i Stambollit** është manuali i njohur universalisht i Kombeve të Bashkuara për hetimin dhe dokumentimin efektiv të torturës dhe formave të tjera të trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues.

privuar nga liria dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në trajtimin dhe rehabilitimin e personave të dënuar. Gjithashtu, janë zhvilluar aktivitete lidhur me sigurinë dinamike dhe përdorimin e instrumenteve për vlerësimin e rrezikut për klientët sprovues, megjithëse disa prej tyre kanë mbetur vetëm pjesërisht të zbatuara.

Në aspektin e infrastrukturës dhe kapaciteteve teknologjike, janë evidentuar investime në pajisje teknologjike dhe logjistike për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës, ndërsa janë funksionalizuar edhe mekanizmat ekzistues të mbikëqyrjes elektronike. Po ashtu, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale lidhur me përdorimin e sallave të videokonferencave dhe qasjen në të dhënat për të burgosurit.

Megjithatë, një numër i konsiderueshëm aktiviteteve nuk janë realizuar gjatë vitit 2025. Nuk janë publikuar të dhënat vjetore për mbikëqyrjen elektronike, nuk është krijuar mekanizmi për mbështetje psikologjike dhe kujdes shëndetësor për personelin e burgjeve, si dhe nuk janë finalizuar analiza dhe plane strategjike për rritjen e masave alternative dhe menaxhimin e ngarkesës së punës në Shërbimin Sprovues të Kosovës. Po ashtu, nuk është formalizuar statusi ligjor i Institutit të Psikiatrisë Forenzike.

Në aspektin e trajtimit dhe rehabilitimit të personave të dënuar, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka realizuar sesione informuese dhe aktivitete rehabilituese me personat e dënuar, duke shënuar rritje të pjesëmarrjes së tyre në programet rehabilituese, aftësimin profesional dhe angazhimin në punë.

**Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Edhe pse janë realizuar zhvillime konkrete në aspektin normativ, rehabilitues, teknologjik dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale, një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve strategjike që lidhen me planifikimin institucional, mbështetjen psikologjike, analizat strategjike dhe mekanizmat e monitorimit kanë mbetur të pazbatuara gjatë vitit 2025.**

#### **Objektivi specifik 5: Sekuestrimi dhe konfiskimi**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 8 aktivitete, prej të cilave asnjë nuk është zbatuar plotësisht gjatë vitit 2025, ndërsa vetëm një aktivitet është zbatuar pjesërisht, që përbën rreth 88% të aktiviteteve të pazbatuara në vitin raportues.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë shumë i kufizuar. Shumica e aktiviteteve që lidhen me reformën ligjore dhe institucionale për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë nuk janë realizuar gjatë vitit 2025, kryesisht për shkak të mosfunksionalizimit të Kuvendit dhe Qeverisë.

---

Për më shumë, shih: <https://www.ohchr.org/en/publications/policy-and-methodological-publications/istanbul-protocol-manual-effective-0>

Në aspektin normativ, Ministria e Drejtësisë nuk ka arritur të procedojë dhe miratojë ndryshimet ligjore të parapara për konfiskimin e pasurisë, përfshirë ndryshimin e legjislacionit për shpërndarjen e të hyrave nga konfiskimi dhe rishikimin e kompetencave të AAPSK-së. Megjithatë, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar aktivitete përgatitore dhe janë hartuar draftet përkatëse ligjore.

Po ashtu, Ligji për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme nuk është miratuar gjatë vitit 2025. Gjatë vitit 2026, projektligji ka avancuar deri në fazën e miratimit në lexim të parë në Kuvend dhe ka kaluar në procedura konsultative dhe shqyrtuese. Si rrjedhojë, as themelimi i Byrosë, zgjedhja e drejtorit dhe miratimi i akteve nënligjore nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve, Akademia e Drejtësisë ka realizuar pjesërisht trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë në fushën e konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurisë, ndërsa aktivitetet tjera që lidhen me funksionalizimin institucional dhe mekanizmat e konfiskimit kanë mbetur të pazbatuara.

**Konkluzion:** *Progresi në këtë objektiv ka qenë shumë i kufizuar. Edhe pse gjatë viteve 2025 dhe 2026 janë evidentuar zhvillime procedurale dhe ligjore lidhur me Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe ndryshimet e legjislacionit përkatës, shumica e aktiviteteve kyçe kanë mbetur të pazbatuara dhe pa rezultate konkrete në funksionalizimin e mekanizmave për sekuestrim dhe konfiskim.*

### **Objektivi strategjik 3: Fuqizimi i sistemit të Drejtësisë Civile dhe Administrative**

#### **Objektivi specifik 1: Funksionimi i drejtësisë civile dhe të drejtat pronësore**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 17 aktivitete, prej të cilave 2 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 14 aktivitete nuk janë zbatuar gjatë këtij viti, që përbën rreth 82% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i mangët, me shumicën e aktiviteteve të pazbatuara gjatë vitit 2025. Një pjesë e konsiderueshme e reformave ligjore kanë mbetur në fazën e draftimit ose procedimit, pa u miratuar për shkak të mosfunksionalizimit të Qeverisë dhe Kuvendit gjatë vitit 2025.

Në aspektin normativ, Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile kanë qenë të finalizuara dhe të proceduara për miratim në Qeveri që nga fundi i vitit 2024, mirëpo nuk janë shqyrtuar për miratim gjatë vitit 2025. Si rrjedhojë, nuk janë realizuar ndryshimet që synonin rritjen e efikasitetit në trajtimin e kontesteve civile, përdorimin e komunikimit elektronik, mbajtjen e seancave në distancë, zgjidhjen e rasteve sipas vendimeve model dhe kufizimin e rasteve të kthimit në rigjykim.

Po ashtu, nuk është miratuar Ligji për Tokën Ndërtimore dhe nuk janë finalizuar ndryshimet në legjislacionin për ndërmjetësimin, përfshirë përcaktimin e autorizimeve dhe përgjegjësi të ndërmjetësuesve dhe trajnimin e vazhdueshëm të detyrueshëm për ta. Megjithatë, është hartuar drafti fillestar për ndryshimet në Ligjin për Ndërmjetësimin.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale, Akademia e Drejtësisë ka realizuar pjesërisht trajnimet për gjyqtarët, ndërmjetësuesit dhe stafin mbështetës lidhur me ndërmjetësimin dhe procedurat civile. Janë organizuar trajnime për referimin e lëndëve në ndërmjetësim, ndërmjetësimin e detyrueshëm në rastet familjare dhe procedurat përmbartimore. Po ashtu, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë në fushën civile, penale dhe administrative.

Në anën tjetër, është evidentuar si aktivitet i zbatuar nënshkrimi i memorandumit ndërmjet KGJK-së dhe Odës së Përmbartuesve Privatë për lehtësimin e komunikimit elektronik në procedurat përmbartimore, megjithëse zbatimi praktik i tij nuk kishte filluar ende deri në maj 2026 për shkak të çështjeve teknike dhe organizative.

***Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i kufizuar. Edhe pse janë evidentuar zhvillime në aspektin e trajnimeve dhe komunikimit elektronik në procedurat përmbartimore, shumica e aktiviteteve kyçe që lidhen me reformën legjislative civile, të drejtat pronësore dhe ndërmjetësimin nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.***

## **Objektivi specifik 2: Funksionimi i drejtësisë komerciale**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 13 aktivitete, prej të cilave 6 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 nuk janë zbatuar gjatë këtij viti, që përbën rreth 46% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm, me zhvillime më të dukshme në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe trajnimeve për gjyqtarët, bashkëpunëtorët profesionalë dhe stafin mbështetës të Gjykatës Komerciale, ndërsa aktivitetet që lidhen me unifikimin e praktikës gjyqësore dhe standardizimin e procedurave kanë mbetur kryesisht të pazbatuara.

Në aspektin e zhvillimit profesional, Akademia e Drejtësisë ka realizuar një numër të konsiderueshëm trajnimesh në fushën komerciale gjatë vitit 2025. Janë mbajtur gjithsej 13 trajnime që kanë trajtuar legjislacionin dhe praktikën gjyqësore në çështjet komerciale, ku kanë marrë pjesë gjyqtarë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë të Gjykatës Komerciale. Po ashtu, kurrikulat trajnuese për gjyqtarët e rinj dhe bashkëpunëtorët profesionalë kanë qenë të hartuara dhe funksionale, pa nevojë për rishikim shtesë.

Në anën tjetër, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata Komerciale nuk kanë përgatitur përmbledhjet e praktikës gjyqësore, format standarde të vendimeve dhe manualët për menaxhimin e rasteve për stafin mbështetës të Gjykatës Komerciale. Këto aktivitete, që synojnë unifikimin e praktikës dhe standardizimin procedural, kanë mbetur të pazbatuara gjatë vitit 2025.

Në raport me monitorimin dhe vlerësimin e funksionimit të Gjykatës Komerciale, aktiviteti për realizimin e anketave për perceptimin e bizneseve është zbatuar vetëm pjesërisht.

Sa i përket mekanizmave alternativë për zgjidhjen e kontesteve, Ministria e Drejtësisë nuk ka organizuar tryeza ndërinstucionale për promovimin e arbitrazhit dhe nuk ka ofruar të dhëna publike për organizimin e trajnimeve për ndërmjetësuesit në fushën komerciale. Ndërkaq, Oda e Avokatëve të Kosovës ka realizuar trajnimet për avokatët lidhur me procedurën e arbitrazhit.

**Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Edhe pse janë realizuar zhvillime konkrete në aspektin e trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale në Gjykatën Komerciale, aktivitetet që lidhen me unifikimin e praktikës gjyqësore, standardizimin procedural dhe promovimin institucional të arbitrazhit kanë mbetur kryesisht të pazbatuara gjatë vitit 2025.**

### **Objektivi specifik 3: Funksionimi i drejtësisë administrative**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 14 aktivitete, prej të cilave 9 janë zbatuar plotësisht, 4 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 nuk është zbatuar gjatë këtij viti, që përbën rreth 7% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit. Një pjesë e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2025 kanë vazhduar të realizohen edhe gjatë vitit 2026.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i dukshëm, veçanërisht në aspektin e funksionalizimit të Gjykatës Administrative, organizimit të trajnimeve dhe forcimit të mekanizmave institucionalë në fushën administrative.

Në aspektin normativ dhe institucional, Ligji për Gjykatën Administrative ishte miratuar nga Kuvendi në dhjetor të vitit 2024, mirëpo hyrja në fuqi dhe funksionalizimi i plotë i Gjykatës Administrative u shty deri në vitin 2026 për shkak të procedurës së vlerësimit kushtetues në Gjykatën Kushtetuese. Pas aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese të muajit janar 2026, ligji hyri në fuqi më 22 janar 2026, ndërsa Gjykata Administrative filloi funksionimin më 5 maj 2026. Në këtë periudhë janë ndërmarrë hapa konkretë drejt funksionalizimit të saj, përfshirë caktimin e ushtruesit të detyrës së kryetarit dhe administratorit të gjykatës.

Në raport me kapacitetet njerëzore, procesi i plotësimit të pozitave të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe stafit mbështetës ka qenë në zhvillim e sipër gjatë vitit 2025

dhe 2026. Janë shpallur konkurset dhe një pjesë e procedurave të rekrutimit kanë vazhduar gjatë vitit 2026.

Në aspektin e funksionimit procedural, Gjykata Administrative ka filluar zbatimin e procedurës së shqyrtimit të çështjeve në procedurë me shkrim në përputhje me Ligjin për Konfliktet Administrative. Po ashtu, është krijuar mekanizmi për monitorimin e rasteve gjyqësore që lidhen me përgjegjësinë shtetërore, përmes raportimit institucional dhe mekanizmave ekzistues të monitorimit.

Në aspektin e zhvillimit profesional, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimet për gjyqtarët, bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët e ANJF-së lidhur me legjislacionin administrativ dhe konfliktet administrative. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 7 trajnime në fushën administrative, ndërsa janë hartuar edhe modulet trajnuese për këtë fushë. Po ashtu, Oda e Avokatëve të Kosovës ka realizuar trajnimet për avokatët lidhur me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Në raport me Avokaturën Shtetërore, Rregullorja për Organizimin e Brendshëm ka mbetur në proces të finalizimit, ndërsa gjatë vitit 2025 janë rekrutuar 3 avokatë shtetërorë. Megjithatë, për një pjesë të aktiviteteve që lidhen me monitorimin nga Ministria e Financave të autoriteteve që shkaktojnë kostot më të larta nga rastet gjyqësore, mungojnë të dhëna publike të mjaftueshme për të vlerësuar nivelin e plotë të zbatimit.

***Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i konsiderueshëm, me zhvillime konkrete në funksionalizimin e Gjykatës Administrative, organizimin e trajnimeve dhe forcimin e mekanizmave institucionalë. Megjithatë, disa aktivitete që lidhen me rekrutimin e plotë të stafit dhe finalizimin e akteve të brendshme organizative kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2026.***

#### **Objektivi strategjik 4: Digjitalizimi i drejtësisë**

Në vitin 2025 ishin planifikuar 17 aktivitete, prej të cilave 9 janë zbatuar plotësisht, 3 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 5 nuk janë zbatuar gjatë këtij viti, që përbën rreth 29% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm, me zhvillime më të dukshme në krijimin dhe avancimin e sistemeve elektronike, përmirësimin e infrastrukturës së TI-së dhe funksionalizimin e shërbimeve digjitale në disa institucione të sektorit të drejtësisë. Në këtë drejtim, sistemet elektronike për aplikim online për profesionet e lira ligjore janë funksionalizuar, me përjashtim të aplikimit për provimin e ekspertëve gjyqësorë, i cili më vonë ka kaluar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Në aspektin e sistemeve elektronike dhe bazave të të dhënave, janë realizuar zhvillime konkrete në Shërbimin Sprovues të Kosovës, Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose

Konfiskuar dhe Ministrinë e Drejtësisë, përfshirë zhvillimin e sistemeve për aplikim online për profesionet ligjore, zgjerimin e bazave të të dhënave dhe avancimin e sistemeve për rastet e dhunës në familje. Po ashtu, është avancuar sistemi për ankandet elektronike, i cili gjatë vitit 2025 ka hyrë në fazën përfundimtare të vlerësimit dhe trajnimit të stafit.

Në aspektin e infrastrukturës digjitale dhe sigurisë së informacionit, gjatë vitit 2025 është realizuar avancimi i Qendrës së të Dhënave në Pallatin e Drejtësisë përmes furnizimit me serverë, routerë dhe licenca, ndërsa është përgatitur edhe projekti për zgjerimin e kapaciteteve për periudhën 2026–2027. Gjithashtu, të gjitha Prokuroritë Themelore janë furnizuar me pajisje funksionale për video-konferenca.

Në raport me kapacitetet profesionale dhe koordinimin institucional, janë ndërmarrë hapa për organizimin e trajnimeve profesionale për stafin e TI-së dhe janë hartuar planet për financimin e digjitalizimit në sektorin e drejtësisë. Megjithatë, një pjesë e aktiviteteve kanë mbetur vetëm pjesërisht të zbatuara për shkak të mungesës së buxhetit dhe pezullimit të disa projekteve. Po ashtu, nuk është themeluar ende Këshilli Drejtues për Teknologji Informative në sektorin e drejtësisë dhe nuk janë vendosur standardet ndërkombëtare të certifikimit për stafin e TI-së.

Në anën tjetër, disa aktivitete kanë mbetur të pazbatuara, përfshirë zhvillimin e modulit për qasje në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas përmes platformës e-Kosova dhe hartimin e dispozitave ligjore për nënshkrimin digjital të akteve noteriale. Gjithashtu, sistemi elektronik HelpDesk në KPK ka mbetur në proces implementimi dhe pritet të funksionalizohet gjatë vitit 2026.

**Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Edhe pse janë realizuar zhvillime konkrete në avancimin e sistemeve elektronike, infrastrukturës digjitale dhe shërbimeve të TI-së në sektorin e drejtësisë, një pjesë e aktiviteteve strategjike që lidhen me koordinimin institucional, standardizimin dhe funksionalizimin e plotë të sistemeve digjitale kanë mbetur të pazbatuara ose vetëm pjesërisht të realizuara gjatë vitit 2025.**

### **Objektivi Specifik 1: Qasja në gjykata dhe prokurori dhe mjetet juridike**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 8 aktivitete, prej të cilave 6 janë zbatuar plotësisht, ndërsa 2 nuk janë zbatuar gjatë këtij viti, që përbën rreth 25% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm, me zhvillime më të dukshme në aspektin e bashkëpunimit institucional, ofrimit të ndihmës juridike falas dhe avancimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e viktimave dhe qasjen në drejtësi.

Në aspektin normativ, Ministria e Drejtësisë ka hartuar Projektligjin për Gjykim brenda një Afati të Arsyeshëm Kohor, i cili ka kaluar procedurat e konsultimeve publike dhe është proceduar për

miratim në Qeveri gjatë vitit 2025. Po ashtu, janë hartuar ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale që ndërlidhen me qasjen në gjykatë ndaj vendimeve të prokurorit.

Në aspektin institucional, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka krijuar partneritete dhe marrëveshje bashkëpunimi me organizata joqeveritare për ofrimin e ndihmës juridike falas, ndërsa Oda e Avokatëve të Kosovës ka vazhduar zbatimin e rregullit për ofrimin e rasteve pro bono nga avokatët.

Në raport me ngritjen e kapaciteteve profesionale, janë realizuar trajnimet për zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas lidhur me procedurat për qasjen në drejtësi dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.<sup>33</sup> Po ashtu, janë hartuar kurrikulat dhe janë organizuar trajnimet për Ligjin për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.

Megjithatë, një pjesë e aktiviteteve kanë mbetur të pazbatuara gjatë vitit 2025. Nuk është realizuar pajisja e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave me mjetet e nevojshme për komunikim konfidencial, ndërsa për disa aktivitete që lidhen me avancimin e mekanizmave institucionalë mungojnë të dhëna publike të mjaftueshme për të vlerësuar nivelin e plotë të zbatimit.

**Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm, me zhvillime konkrete në aspektin e bashkëpunimit institucional, ndihmës juridike falas dhe avancimit të kornizës ligjore. Megjithatë, disa aktivitete që lidhen me forcimin e mekanizmave institucionalë dhe mbështetjen teknike për mbrojtjen e viktimave kanë mbetur të pazbatuara gjatë vitit 2025.**

## **Objektivi Specifik 2: Funkcionimi i profesioneve të lira**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 36 aktivitete monitoruese. Nga këto aktivitete, 16 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 19 nuk janë zbatuar gjatë vitit 2025, që përbën rreth 53% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit. Një pjesë e aktiviteteve janë realizuar vetëm gjatë vitit 2026.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm dhe i pabarabartë, me dallime të dukshme ndërmjet profesioneve të ndryshme të lira. Në aspektin normativ, nuk janë miratuar Ligji për Avokatinë dhe Ligji për Ndërmjetësimin gjatë vitit 2025, ndërsa Ligji për Përmbaruesit Privat ka mbetur pjesë e trajtimit në kuadër të Kodit të Procedurës Civile. Po ashtu, nuk janë miratuar disa akte nënligjore dhe mekanizma koordinues që lidhen me funksionimin e profesioneve të lira.

Në aspektin e zhvillimit institucional dhe funksionalizimit të sistemeve, janë evidentuar disa zhvillime konkrete. Sistemi EMS, sipas zyrtarëve të Odës së Përmbarueseve Privat nuk është funksionalizuar edhe pse janë realizuar trajnimet për përdorimin e tij. Gjithashtu, Oda e

---

<sup>33</sup> Raporti vjetor i punës, ANJF 2025. <https://anjf.rks-gov.net/desk/inc/media/C1CF4A2D-2D60-4F59-BCE4-1D70C1C22858.pdf> (Qasur për herë të fundit 10.05.2026).

Administratorëve Falimentues është pajisur me hapësira pune dhe janë ndërmarrë hapa drejt funksionalizimit të saj.

Në raport me zhvillimin profesional dhe trajnimet, një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve janë realizuar nga odat profesionale dhe institucionet përgjegjëse. Janë mbajtur trajnimet për gjyqtarët lidhur me procedurat e falimentimit, trajnimet për administratorët falimentues, trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme për përmbaruesit privat, si dhe trajnimet për ndërmjetësuesit. Po ashtu, janë hartuar dhe zbatuar programe trajnuese për punonjësit e noterëve dhe përmbaruesve privat, ndërsa Akademia e Drejtësisë ka krijuar kurrikulën për trajnimet e përbashkëta tematike ndërmjet profesioneve të lira, gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në anën tjetër, një numër i konsiderueshëm aktivitetsh kanë mbetur të pazbatuara. Nuk janë krijuar mekanizmat koordinues ndërinstitucionalë ndërmjet profesioneve të lira dhe institucioneve të drejtësisë, nuk janë zhvilluar aktivitetet e planifikuara vetëdijësuese për procedurat e falimentimit dhe ndërmjetësimin, si dhe nuk janë krijuar disa nga kurrikulat dhe programet e parapara për trajnim dhe monitorim. Po ashtu, mungojnë të dhëna publike për disa aktivitete që lidhen me transparencën dhe organizimin institucional të Odës së Administratorëve Falimentues.

Sa i përket etikës dhe organizimit të brendshëm profesional, janë miratuar Kodi i Etikës për Administratorët Falimentues, Statuti i Odës së Përmbaruesve Privat dhe Kodi i ri i Etikës për Përmbaruesit Privat. Ndërkaq, rishikimi i Statutit të Odës së Përmbaruesve Privat është realizuar vetëm gjatë vitit 2026.

**Konkluzion: Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Edhe pse janë evidentuar zhvillime konkrete në funksionalizimin e disa sistemeve, organizimin e trajnimeve dhe avancimin e akteve profesionale dhe etike, një pjesë e konsiderueshme e reformave ligjore, mekanizmave koordinues dhe aktiviteteve institucionale kanë mbetur të pazbatuara gjatë vitit 2025.**

**Objektivi Specifik 3: Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe publikun dhe zhvillimi i politikave nga Ministria e Drejtësisë**

*Në vitin 2025 ishin planifikuar 11 aktivitete monitoruese, duke mos përfshirë aktivitetin e përsëritur lidhur me miratimin e Strategjisë për Komunikim me Publikun. Nga këto aktivitete, 4 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 nuk janë zbatuar gjatë këtij viti, që përbën rreth 55% të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.*

Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm, me zhvillime më të dukshme në aspektin e komunikimit publik, aktiviteteve vetëdijësuese dhe koordinimit me donatorët, ndërsa një pjesë e aktiviteteve që lidhen me dialogun e strukturuar me shoqërinë civile dhe matjen e perceptimit publik kanë mbetur të pazbatuara.

Në aspektin e komunikimit institucional, Policia e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, ndërsa Ministria e Drejtësisë nuk ka arritur të përgatisë raportin për zbatimin e Strategjisë për Komunikim me Publikun dhe as të zhvillojë sondazhin fillestar për matjen e njohurive dhe kënaqshmërisë së publikut me shërbimet e ofruara. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë ka publikuar raporte vjetore për punën e saj dhe për rezultatet e punës së MD-së, përfshirë edhe komunikimin me publikun dhe aktivitetet në këtë fushë.

Në raport me bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe publikun, nuk janë realizuar aktivitetet e planifikuara për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për pjesëmarrje aktive në proceset legjislativë dhe reformat në drejtësi. Po ashtu, dialogu i rregullt dhe strukturuar ndërmjet institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile nuk janë zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit 2025. Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, gjatë vitit 2025 janë publikuar 43 kërkesa për konsultim publik, nga të cilat 10 kanë pranuar komente, ndërsa një kërkesë është refuzuar.

Në anën tjetër, Ministria e Drejtësisë ka realizuar aktivitete vetëdijësuese në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizmit” kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe akterë të tjerë relevantë. Gjithashtu, janë mbajtur takime koordinuese me donatorët për implementimin e projekteve të përbashkëta dhe është rekrutuar pjesërisht stafi në Zyrën për Komunikim me Publikun. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se në kuadër të hartimit të Strategjisë për Komunikim 2023–2025 dhe hartimit të Strategjisë së re, janë organizuar konsultime dhe diskutime me partnerë institucionalë dhe organizata të shoqërisë civile.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve, zyrtarët e Zyrës për Komunikim me Publikun kanë ndjekur trajnime lidhur me komunikimin strategjik, ndërsa aktivitetet tjera trajnuese për partneritet, analiza ligjore dhe strategji të avokimit nuk janë realizuar gjatë vitit 2025.

**Konkluzion:** *Progresi në këtë objektiv ka qenë i pjesshëm. Edhe pse janë evidentuar zhvillime në aspektin e komunikimit publik, aktiviteteve vetëdijësuese, konsultimeve publike dhe koordinimit me donatorët, shumica e aktiviteteve që lidhen me dialogun e strukturuar me shoqërinë civile, matjen e perceptimit publik dhe zhvillimin sistematik të politikave kanë mbetur të pazbatuara gjatë vitit 2025.*

## **11. Përputhshmëria e Programit Legjislativ me planin e veprimit**

Gjatë vitit 2025, për shkak të krizës institucionale dhe mungesës së konstituimit të plotë të Kuvendit dhe Qeverisë, nuk është miratuar asnjë projektligj nga Qeveria dhe asnjë ligj nga Kuvendi që ndërlidhet me Strategjinë për Sundimin e Ligjit. Kjo ka bërë që një numër i madh i aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit 2025 të mbeten të pazbatuara dhe të shtyhen për vitin 2026.

Pas konstituimit të Kuvendit dhe formimit të Qeverisë më 11 shkurt 2026, Qeveria miratoi Programin Legjislativ për vitin 2026 më 20 shkurt 2026.<sup>34</sup> Për shkak të ngecjeve të vitit paraprak, Programi Legjislativ i vitit 2026 është dashur të reflektojë në masë të madhe projektligjet e parapara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit për vitet 2025-2026.

Nga analiza e Programit Legjislativ për vitin 2026 rezulton se një pjesë e konsiderueshme e projektligjeve të parapara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë përfshirë edhe në agjendën legjislative të Qeverisë. Kjo përfshin Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për KPK-në, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për KGJK-në, Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Projektligjin për Gjykatat, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, Projektligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, Projektligjin për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile, Projektligjin për Ndërmjetësim, Projektligjin për Ndihmë Juridike Falas, Projektligjin për realizimin e të drejtës në gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe Projektligjin për Avokatinë.

Kjo tregon se, në përgjithësi, ekziston një nivel i konsiderueshëm i harmonizimit ndërmjet Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Programit Legjislativ për vitin 2026. Në këtë drejtim, përfshirja e shumicës së projektligjeve të parapara në Planin e Veprimit në Programin Legjislativ përbën një zhvillim pozitiv, duke reflektuar një përpjekje për ta ndjekur agjendën e reformave në sektorin e drejtësisë.

Kategoria	Numri
Projektligje të parapara në SSL/PV 2025-2026	15
Të përfshira në Programin Legjislativ 2026	13
Të munguara në Programin Legjislativ 2026	2

**Tabela 2. Përputhshmëria e Programit Legjislativ 2026 me Projektligjet e parapara në SSL/PV 2025-2026**

Megjithatë, Programi Legjislativ për vitin 2026 nuk i përfshin të gjitha projektligjet e parapara në Strategji. Dy projektligje të rëndësishme që mungojnë janë Projektligji për Tokën Ndërtimore dhe Projektligji për Përmbaruesit Privat. Mungesa e këtyre projektligjeve tregon se harmonizimi ndërmjet Strategjisë dhe Programit Legjislativ nuk është i plotë dhe se disa reforma të rëndësishme në fushën e pronës dhe përmbarimit privat rrezikojnë të shtyhen edhe më tej.

**Projektligjet që mungojnë në Programin Legjislativ 2026**

1. Projektligji për Tokën Ndërtimore

<sup>34</sup> Programi i Projektligjeve të Qeverisë për vitet 2026-2028, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2026. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Programi-i-Projektligjeve-per-vitet-2026-2028.pdf> (Qasur për herë të fundit 10.05.2026).

**Tabela 3. Projektligjet që mungojnë në Programin Legjislativ 2026 krahasuar me SSL/PV 2025-2026**

Përveç përfshirjes së projektligjeve në Programin Legjislativ, disa prej tyre tashmë kanë hyrë edhe në fazën e konsultimeve publike në Platformën Online për Konsultime Publike. Këtu përfshihen Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KGJK-në, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPK-në, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, Projektligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe Projektligji për rekrutimin, vlerësimin e performancës, kontrollin e integritetit dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Procesi i hartimit të kësaj pakoje ligjore ka filluar që pas miratimit të Ligjeve për Reformën në Drejtësi dhe gjatë viteve 2024–2025 projektligjet janë proceduar edhe për opinion në Komisionin e Venecias. Kjo tregon se, të paktën për një pjesë të reformave prioritare, tashmë ka filluar procesi konkret i hartimit dhe procedimit të legjislacionit.

Në përfundim, Programi Legjislativ për vitin 2026 është në masë të madhe i harmonizuar me aktivitetet e Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Planit të Veprimit 2025-2026. Megjithatë, mungesa e disa projektligjeve të rëndësishme dhe përvoja e viteve të kaluara tregojnë se përfshirja e tyre në program nuk është e mjaftueshme.

## **12. Çfarë synohej vs. çfarë u arrit me Strategjinë e Sundimit të Ligjit**

Strategjia për Sundimin e Ligjit (SSL) 2021-2026 u hartua si dokumenti kryesor reformues për sektorin e drejtësisë në Kosovë, me synimin për të adresuar problemet e kahershme në funksionimin e gjyqësorit, prokurorisë, luftën kundër korrupsionit dhe qasjen në drejtësi. Strategjia u bazua në procesin e Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, i cili identifikoi mangësitë kryesore në administrimin e drejtësisë, mungesën e efikasitetit, mungesën e llogaridhënies, problemet me integritetin institucional dhe qasjen e kufizuar të qytetarëve në drejtësi.

SSL synonte rikthimin e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial përmes reformave të thella në katër fusha kryesore: funksionimin e gjyqësorit dhe prokurorisë, drejtësinë penale, qasjen në drejtësi dhe anti-korrupsionin. Në aspektin praktik, Strategjia synonte uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura, rritjen e profesionalizmit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përmirësimin e sistemit të vlerësimit të performancës, forcimin e integritetit institucional, avancimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe përmirësimin e qasjes së qytetarëve në gjykata, prokurori dhe mjete juridike efektive.

Një ndër synimet kryesore të SSL-së ishte që reformat të mos mbeteshin vetëm në nivel dokumentesh, por të përktheheshin në ndryshime konkrete ligjore dhe institucionale. Për këtë arsye, Strategjia dhe Plani i Veprimit parashihnin një numër të madh aktivitetesh, duke filluar nga

miratimi i projektligjeve dhe standardeve të reja, deri te krijimi i mekanizmave të rinj institucionalë, rritja e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstytucional.

Megjithatë, zbatimi i SSL-së nuk ka arritur të prodhojë rezultatet e synuara në masën e paraparë. Edhe pse në disa raste janë ndërmarrë hapa konkretë, si hartimi i projektligjeve, miratimi i disa standardeve apo themelimi i mekanizmave të caktuar, shumë aktivitete kanë mbetur vetëm në fazën e planifikimit, konsultimeve publike ose janë zbatuar pjesërisht. Në shumë raste, institucionet janë fokusuar më shumë në hartimin e dokumenteve sesa në zbatimin praktik të tyre.

Problemet më të mëdha janë evidentuar në raport me mungesën e koordinimit institucional, mungesën e monitorimit, vonesat në miratimin e projektligjeve dhe mungesën e buxhetit adekuat. Përkundër faktit se SSL ishte miratuar nga vetë Qeveria, shumë aktivitete të parapara nuk janë reflektuar në planifikimin buxhetor dhe nuk janë shoqëruar me burime të mjaftueshme financiare për zbatim. Kjo ka bërë që shumë objektiva të mbeten vetëm deklarative.

Një problem i vazhdueshëm ka qenë edhe mospërputhja ndërmjet asaj që parashihej në Strategji dhe asaj që institucionet kanë ndërmarrë në praktikë. IKD ka evidentuar raste kur projektligjet ose reformat e ndërmarra nuk kanë qenë në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Kjo është vërejtur sidomos te reforma e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe çështjet që lidhen me qasjen në gjykatë ndaj vendimeve prokuroriale.

Po ashtu, raportimi institucional për zbatimin e SSL-së shpeshherë nuk ka reflektuar gjendjen reale në terren. Në raportet zyrtare janë evidentuar aktivitete si të përmbushura ose pjesërisht të përmbushura, edhe në rastet kur ato nuk kanë filluar fare ose nuk kanë prodhuar rezultate konkrete. Kjo ka krijuar një perceptim artificial për progres më të madh sesa ai që ka ekzistuar realisht.

Gjatë viteve 2022 dhe 2023, IKD ka evidentuar se një numër i konsiderueshëm aktiviteteve të planifikuara nuk janë realizuar brenda afateve të parapara. Dhjetëra aktivitete të vitit 2022 kanë mbetur të pazbatuara edhe gjatë vitit 2023, ndërsa shumë të tjera kanë mbetur në statusin “pjesërisht të zbatuara” pa ndonjë progres real. Për më tepër, një numër aktiviteteve që nuk kërkonin pengesa të mëdha financiare apo institucionale kanë mbetur pa u realizuar.

Një tjetër problem i rëndësishëm ishte fakti se Plani i Veprimit fillestar skadoi në fund të vitit 2023, ndërsa rishikimi afatmesëm i Strategjisë dhe miratimi i Planit të ri të Veprimit nuk u bënë brenda afateve të parapara nga vetë Strategjia. Kjo krijoi një periudhë ku Strategjia mbeti në fuqi, por pa një plan konkret veprimi për zbatim. Në praktikë, kjo e paralizoi zbatimin e SSL-së për një periudhë të konsiderueshme.

Rishikimi afatmesëm i Strategjisë dhe Planit i Veprimit 2025-2026 synuan të korrigojnë disa nga mangësitë e fazës së parë të zbatimit, duke përfshirë aktivitete të reja dhe duke riformuluar prioritetet. Megjithatë, edhe dokumentet e rishikuara kanë ruajtur probleme të ngjashme, sidomos në raport me mungesën e vlerësimit të qartë buxhetor. Në anën tjetër, procesi i rishikimit është mbështetur në analiza dhe dokumente politike të hartuara nga grupe punuese ndërinstitucionale, të cilat kanë trajtuar fusha prioritare të reformës në drejtësi dhe kanë shërbyer si bazë për hartimin e Planit të Veprimit 2025–2026.

Nëse SSL do të zbatohet plotësisht, sistemi i drejtësisë në Kosovë do të duhej të ishte më efikas, më transparent, më profesional dhe më i qasshëm për qytetarët. Do të duhej të kishte më pak lëndë të pazgjidhura, më shumë mjete juridike efektive, më shumë integritet institucional, më shumë rezultate në luftën kundër korrupsionit dhe më shumë besim të qytetarëve në drejtësi. Megjithatë, deri në fund të periudhës së zbatimit, mbetet e qartë se shumë nga objektivat kryesore të SSL-së nuk janë arritur plotësisht dhe se sektori i sundimit të ligjit vazhdon të përballet me shumë nga problemet që Strategjia synonte t'i adresonte.

### **13. Mungesa e monitorimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit**

Pas konstituimit të Kuvendit<sup>35</sup> dhe formimit të Qeverisë<sup>36</sup> më 11 shkurt 2026, pritej që të rifillonte edhe monitorimi institucional i Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Planit të Veprimit 2025-2026. Megjithatë, deri në fund të muajit prill 2026, nuk rezultoi të jetë mbajtur asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues të Strategjisë, ndonëse ky mekanizëm është përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e aktiviteteve të parapara.

Po ashtu, gjatë vitit 2025 nuk është evidentuar publikimi i raportit gjashtëmuor për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, siç kërkohet me vet Strategjinë. Për këtë periudhë, nuk është evidentuar asnjë komunikim publik nga Ministria e Drejtësisë lidhur me progresin e Strategjisë, qoftë përmes publikimit të raporteve, njoftimeve për takime koordinuese, prioritetive të reja apo vonesave në zbatim.

Gjithashtu, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet specifik që lidhet me mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë. Kjo tregon se, edhe pas krijimit të institucioneve të reja, Strategjia për Sundimin e Ligjit nuk është rikthyer ende si prioritet i qartë politik dhe institucional.

---

<sup>35</sup> U konstituua Legjislatura X e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2026. <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/u-konstituua-legjislatura-x-e-kuvendit-te-rep-36955/>. (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

<sup>36</sup> Kuvendi zgjodhi Qeverinë e re të Kosovës me kryeministër Albin Kurtin, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2026. <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/kuvendi-zgjodhi-qeverine-e-re-te-kosoves-me-k-36958/>. (Qasur për herë të fundit 14.04.2026).

Pas konstituimit të institucioneve të reja, Qeveria dhe Kuvendi është dashur ta trajtojnë Strategjinë për Sundimin e Ligjit si një nga prioritetet kryesore të mandatit. Duke qenë se viti 2025 ka qenë pothuajse tërësisht i humbur për shkak të krizës institucionale, periudha pas 11 shkurtit 2026 është dashur të shfrytëzohet për rikuperimin e vonesave, përmes aktivizimit të menjëhershëm të mekanizmave monitorues dhe procedimit të reformave prioritare.

Komiteti Drejtues është dashur të mbledhet menjëherë pas formimit të institucioneve, me qëllim të vlerësimit të aktiviteteve të përfunduara gjatë vitit 2025, identifikimit të pengesave dhe përcaktimit të afateve të reja për zbatimin e tyre.

Po ashtu, Komiteti Drejtues është dashur siç ka bërë zakonisht të faqja e Ministrisë së Drejtësisë të publikojë raporte periodike, njoftime për progresin e aktiviteteve dhe informacione për projektligjet që janë në procedim. Raportimi publik do të ndihmonte në rritjen e transparencës, do të lehtësonte monitorimin nga shoqëria civile dhe do të rriste presionin institucional për zbatimin e reformave të parapara.

#### **14. Si duhet t'i qaset Qeveria Sundimit të Ligjit, pas përfundimit të strategjisë**

Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026 ka hyn në fazën përfundimtare të saj. Sipas afateve të përcaktuara në vetë Strategjinë, gjatë vitit 2026 duhet të realizohet vlerësimi përfundimtar i saj, pas rishikimit afatmesëm që është bërë në vitin 2024. Ky vlerësim duhet të shërbejë jo vetëm për të matur nivelin e realizimit të aktiviteteve, por edhe për të identifikuar dobësitë strukturore që kanë penguar zbatimin e saj gjatë gjithë periudhës 2021-2026.

Qeveria nuk duhet t'i qaset përfundimit të Strategjisë vetëm si mbyllje formale e një dokumenti të politikave. Përkundrazi, viti 2026 duhet të shfrytëzohet për të bërë një vlerësim të thellë të reformave që kanë funksionuar, atyre që kanë dështuar dhe arsyeve konkrete pse një pjesë e madhe e aktiviteteve nuk janë zbatuar. Në këtë proces duhet të analizohen jo vetëm rezultatet e institucioneve të drejtësisë, por edhe pengesat politike, mungesa e koordinimit, mungesa e kapaciteteve dhe sidomos mungesa e financimit.

Një nga mësimet kryesore nga zbatimi i Strategjisë 2021-2026 është se reformat në sundimin e ligjit nuk mund të mbështeten vetëm në lista të gjata aktiviteteve dhe objektivash. Përvoja e viteve të fundit ka treguar se shumë aktivitete kanë mbetur të pazbatuara për shkak të mungesës së prioritizimit, mungesës së buxhetit dhe mungesës së koordinimit ndër-institucional. Për më tepër, zbatimi efektiv i reformave në sundimin e ligjit mbetet i lidhur ngushtë me ekzistimin e vullnetit politik të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, formimi i qeverisë së re pas zgjedhjeve të 7 qershorit paraqet momentin kyç për riaktivizimin e agjendës së reformave dhe për adresimin e vonesave të akumuluar gjatë periudhës së krizës institucionale.

Pas përfundimit të Strategjisë aktuale, Qeveria duhet të shqyrtojë seriozisht nevojën për një strategji të re për sundimin e ligjit. Megjithatë, para miratimit të një dokumenti të ri, duhet të bëhet

një rishikim i mirëfilltë i institucioneve dhe mekanizmave ekzistues. Duhet të vlerësohet nëse struktura aktuale e Komitetit Drejtues, organit koordinues dhe sekretariatit ka funksionuar në praktikë, nëse institucionet kanë pasur kapacitete të mjaftueshme dhe nëse mënyra e raportimit dhe monitorimit ka qenë efektive.

Një strategji e re nuk duhet të jetë vetëm vazhdimësi e dokumentit ekzistues me aktivitete të reja. Ajo duhet të ndërtohet mbi një analizë të qartë të problemeve që kanë penguar zbatimin e Strategjisë aktuale. Kjo nënkupton që para hartimit të saj duhet të zhvillohet një proces i gjerë konsultimi me institucionet e drejtësisë, shoqërinë civile, odat profesionale, komunitetin akademik dhe partnerët ndërkombëtarë.

Po ashtu, një nga elementet kryesore të qasjes së re duhet të jetë planifikimi real financiar. Strategjia e ardhshme duhet të shoqërohet që në fillim me një vlerësim të plotë të kostos, me burimet konkrete të financimit dhe me integrimin e saj në dokumentet buxhetore afatmesme. Përndryshe, ekziston rreziku që të përsëriten të njëjtat probleme që kanë karakterizuar Strategjinë 2021-2026, ku shumë aktivitete janë planifikuar pa pasur mbështetje reale financiare.

Qeveria duhet po ashtu të fokusohet më shumë në rezultatet konkrete dhe jo vetëm në numrin e aktiviteteve të realizuara. Për shembull, rëndësi më të madhe duhet të ketë nëse është rritur efikasiteti i gjykatave, nëse është përmirësuar qasja në drejtësi, nëse është zvogëluar numri i lëndëve të pazgjidhura, nëse janë forcuar mekanizmat kundër korrupsionit dhe nëse qytetarët kanë më shumë besim në institucionet e drejtësisë.

Një tjetër element i rëndësishëm është nevoja për një koordinim më të mirë ndërinstytucional. Përvoja e deritanishme ka treguar se shumë aktivitete varen nga bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Kuvendit, KGJK-së, KPK-së, Ministrisë së Financave dhe institucioneve të tjera. Në mungesë të një koordinimi të tillë, reformat rrezikojnë të mbeten të fragmentuara dhe të pazbatuara.

Në fund, pas përfundimit të Strategjisë aktuale, Qeveria duhet të kalojë nga qasja formale e hartimit të dokumenteve drejt një qasjeje më funksionale dhe më të matshme për sundimin e ligjit. Nuk mjafton vetëm miratimi i strategjive dhe planeve të veprimit. Ajo që ka rëndësi është nëse këto dokumente prodhojnë ndryshime konkrete në funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe në jetën e qytetarëve.

## 15. Rekomandime

- Institucionet përgjegjëse të prioritizojnë zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë për Sundimin e Ligjit që nuk kërkojnë ndryshime legislative dhe miratim nga Kuvendi i Kosovës, me fokus në masat administrative, aktet nënligjore, ngritjen e kapaciteteve, digjitalizimin dhe mekanizmat e koordinimit institucional, me qëllim minimizimin e ndikimit të bllokadave politike në zbatimin e reformave.
- Të forcohet koordinimi ndërinstytucional ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, përmes mekanizmave të rregullt të planifikimit, raportimit dhe monitorimit të progresit për secilin veprim të planifikuar.
- Të krijohen mekanizma të përhershëm koordinues për vazhdimësinë e reformave në sektorin e drejtësisë gjatë periudhave të krizave politike apo tranzicionit institucional, me qëllim shmangien e ndërprerjes së zbatimit të reformave.
- Pas zgjedhjeve të 7 qershorit 2026 dhe konstituimit të institucioneve të reja, Qeveria dhe institucionet përgjegjëse të hartojnë plan përshpejtues për realizimin e aktiviteteve të mbetura nga viti 2025 dhe atyre të planifikuara për vitin 2026, duke përcaktuar afate konkrete dhe përgjegjësi institucionale.
- Në procesin e rishikimit të ndarjeve buxhetore, Qeveria të sigurojë alokim adekuat të mjeteve financiare për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, veçanërisht për veprimet që aktualisht nuk kanë kosto të përcaktuara apo burime financimi të identifikuar.
- Qeveria të iniciojë procesin e vlerësimit përfundimtar të zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026, duke analizuar nivelin e realizimit, pengesat strukturore, ndikimin real të reformave dhe mësimet e nxjerra, si bazë për hartimin e Strategjisë së re për Sundimin e Ligjit 2027–2032.
- Qeveria të iniciojë gjatë vitit 2026 procesin e hartimit të Strategjisë së re për Sundimin e Ligjit 2027–2032, me qëllim që strategjia e re dhe Plani përkatës i Veprimit të miratohen para fillimit të vitit 2027, duke mundësuar nisjen e zbatimit të reformave që nga fillimi i periudhës strategjike. Procesi i hartimit duhet të bazohet në vlerësimin gjithëpërfshirës të zbatimit të Strategjisë 2021–2026 dhe të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante të sektorit të drejtësisë, përfshirë Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile, me qëllim sigurimin e prioriteteve reale të sektorit, koordinimit institucional dhe harmonizimit me standardet evropiane.